



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**UDHËZUES KURRIKULAR LËNDOR PËR TIK-un**  
Material ndihmës për mësuesit e TIK-ut në arsimin e mesëm të lartë



**KLASAT 10-12**

TIRANË, 2018

**Përgatiti udhëzuesin:**

*Irida Sina, IZHA*

**Kontribuan:**

*Almir Gjata, shkolla “Petro Nini Luarasi”, Tiranë*

*Armand Haka, shkolla “Besnik Sykja”, Tiranë*

Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës “TIK” në arsimin e mesëm të lartë është produkt i konsultimeve dhe i diskutimeve me mësues dhe me specialistë të kësaj lënde në këtë cikël shkollimi.

*Prodhim i IZHA-s, 2018*

[www.izha.edu.al](http://www.izha.edu.al)

*Copy right © IZHA*

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

<b>Qëllimi i udhëzuesit</b> .....	<b>4</b>
<b>1. Qëllimi dhe organizimi i TIK-ut në AML</b> .....	<b>5</b>
<b>2. Modele të zhvillimit të kompetencave kyçe nëpërmjet lëndës</b> .....	<b>8</b>
<b>Rezultatet e të nxënit për secilën kompetencë në lëndën e TIK-ut dhe shembuj se si ato lidhen me kompetencat kyçe.</b> .....	<b>9</b>
<b>3. Modele të integrimit ndër-lëndor brenda dhe jashtë fushës së të nxënit</b> .....	<b>13</b>
<b>4. Metodologjia për zhvillimin e lëndës</b> .....	<b>16</b>
<b>4.1 Inteligjencat e shumëfishta</b> .....	<b>18</b>
<b>5. Modele të planifikimit kurrikular të lëndës</b> .....	<b>26</b>
<b>MODEL PLANI VJETOR</b> .....	<b>28</b>
<b>MODEL PLANI TRE-MUJOR</b> .....	<b>30</b>
<b>MODEL PLANI DITOR</b> .....	<b>34</b>
<b>6. Vlerësimi i nxënësve</b> .....	<b>39</b>
<b>7. Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse</b> .....	<b>44</b>
7.1 Hartimi i testit.....	46
<b>MODEL TESTESH</b> .....	<b>51</b>
<b>8. Projekti kurrikular</b> .....	<b>54</b>
Realizimi i një projekti kurrikular nëpërmjet metodës së Projektit kërkimor.....	57
<b>IX. Portofoli në lëndën e TIK-ut.</b> .....	<b>59</b>
<b>Fazat e krijimit të portofolit të nxënësit</b> .....	<b>61</b>
<b>Planifikimi I portofolit: Gjimnazi Besnik Sykja, Mësues: Armand HARKA</b> .....	<b>66</b>
<b>XI. Bibliografia:</b> .....	<b>71</b>

## **Qëllimi i udhëzuesit**

Udhëzuesi ka si qëllim zbatimin praktik në klasë të lëndës si dhe zgjidhjen e disa sfidave me të cilat janë përballur mësuesit e lëndës gjatë implementimit të kurrikulës me kompetenca.

Vitet e fundit përdorimi i aftësisë TIK ka sjellë ndryshime në cilësinë e mësimdhënies në të gjitha lëndët, por këto ndryshime nuk kanë qenë të barabarta në të gjitha shkollat dhe në të gjitha lëndët. Prandaj hartimi i këtij udhëzuesi është parë si një domosdoshmëri për t'u përballur me sukses me implementimin e koncepteve të reja të kurrikulës me kompetenca.

Ky udhëzues, është konceptuar i ndarë në shtatë kapituj, si një paketë dokumentesh të hartuara për të nxitur përdorimin e TIK-ut në shkollë. Fillimisht tregohet qëllimi i lëndës së TIK-ut, shtrirja e saj si dhe klasat në të cilat zhvillohet kjo lëndë. Në kapitullin e III-të jepen shembuj konkret se si disa nga rezultatet e të nxëniet të kompetencave kyçe arrihen nëpërmjet lëndës së TIK-ut. Përdorimi i TIK-ut në mësimdhënie është një vlerë e shtuar për mësuesit gjatë mësimdhënies dhe ofron një qasje të re në këtë proces.

Në kapitullin e IV-t i kushtohet rëndësi e veçantë integritimit ndërlëndor, duke e pasuruar këtë rubrikë me modele dhe shembuj konkrete. TIK-u u shërben të gjitha fushave, me koncepte, me aftësi dhe lidhja e TIK-ut me fushat e tjera pasuron situatat e mësimin në të cilat nxënësi zhvillon kompetencat e tij. Përdorimi i teknologjisë ndihmon në përvetësimin më mirë të lëndëve të tjera nga nxënësi duke i bërë ato më të kuptueshme dhe më afektive. TIK-u luan një rol të rëndësishëm në të gjitha fushat e tjera. Përdorimi i TIK-ut duhet të shihet si një mjet që i ndihmon nxënësit të përqendrohen më gjatë në klasë, pasi informacioni mund të transmetohet në forma të ndryshme: audio-vizive (eksperimentet virtuale, filmat dokumentarë, prezantime PowerPoint, postera, leximi online, ndarja e informacioneve me shkollat e tjera nëpërmjet e-mail-it).

Në kapitullin e V-të, përshkruhet rëndësia e përdorimit të metodave ndërvepruese dhe jepen modele të përdorimit të metodave, teknikave dhe strategjive që përdoren për zhvillimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe.

Në kapitullin e VI-të jepen modele të planifikimit lëndor, modele të planeve vjetore, planeve të periudhave si dhe plan-ditarëve.

Në kapitullin e VII-të **jepet informacion i detajuar rreth vlerësimit të nxënësve në klasë**. Përdorimi i TIK-ut gjithashtu, ndihmon bërjen e vlerësimeve dhe raporteve sa më efektive për nxënësit dhe mësuesit. Gjatë procesit të vlerësimit në klasë mësuesit duhet të kenë në fokus vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe realizimit të kompetencave kyçe por dhe kompetencave të fushës. Në të njëjtin kapitull jepen modele testesh dhe metodash për realizimin e testeve efektive. Rëndësi i kushtohet edhe portofolit të nxënësve, detyrave që ata duhet të plotësojnë si dhe mënyrës së vlerësimit të portofolit.

## **1. Qëllimi dhe organizimi i TIK-ut në AML**

### **Qëllimi i programit të fushës së TIK-ut:**

Programi i TIK-ut ka për qëllim të zhvillojë njohuritë, të kuptuarit dhe aftësitë, për të siguruar që nxënësit individualisht dhe në bashkëpunim:

- të hetojnë, projektojnë, planifikojnë, menaxhojnë, krijojnë dhe vlerësojnë zgjidhjet;
- të jenë kreativë, inovativë dhe me iniciativë kur përdorin tradicionalen, bashkëkohoren e teknologjitë e reja dhe të kuptojnë se si janë zhvilluar teknologjitë me kalimin e kohës;
- të marrin vendime të informuara dhe etike në lidhje me, rolin, ndikimin dhe përdorimin e teknologjive në ekonomi, mjedis dhe shoqëri për një të ardhme të qëndrueshme ;
- të angazhohen me besim dhe përgjegjësi që të zgjidhin dhe të manipulojnë me teknologjitë e përshtatshme, materialet, të dhënat, sistemet, komponentët, mjetet dhe pajisjet, kur projektojnë dhe krijojnë zgjidhje;
- të analizojnë, vlerësojnë, kritikojnë problemet, nevojat apo mundësitë për të identifikuar dhe për të krijuar zgjidhje.

**Mendimi kompjuterik** i nxënësve duhet të zhvillohet gjatë gjithë klasës së 12-të. Ai përfshin këto aftësi:

- zbërthimin (shpërbërjen) - zbërthimin e sistemeve komplekse në sisteme më të vogla dhe më të menaxhueshme;
- njohjen e modeleve – kërkimin e ngjashmërive, midis dhe tek problemet;
- abstraksionin – fokusimin tek informacioni i rëndësishëm duke injoruar detajet e

parëndësishme, ose fshehur detajet e implementimit;

- mendimin algoritmik – zhvillimin e zgjidhjes së problemit hap-pas-hapi, ose hapat e ndjekur për të zgjidhur problemin.

**Lënda e Tik-ut realizohet me 1 orë në javë në klasën e 10-të dhe të 11-të. Në klasën e 11-të është edhe TIK avancë me 1 orë në javë si lëndë me zgjedhje. Ndërkohë në klasën e 12-të TIK ofrohet si lëndë me zgjedhje me 2 orë në javë.** Programi i lëndës së TIK-ut specifikon peshën (*orët e sugjeruara*) e secilës tematikë për secilën shkallë dhe klasë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore, të përcaktuara në planin mësimor të arsimit bazë. Kjo ka si qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

Tematikat janë baza për të siguruar rezultatet e të nxënësve dhe për secilën tematikë janë paraqitur njohuritë korresponduese të klasës. Aftësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të demonstrojnë nxënësi lidhur me tematikat përkatëse paraqiten vetëm në nivel shkalle. Koha për secilën tematikë, lidhet së pari me rëndësinë e tematikës dhe së dyti me shkallën e vështirësisë së saj për t'u përvetësuar nga nxënësit. Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Mësuesit janë të lirë të ndryshojnë me 10% (më shumë ose më pak) orët e rekomanduara për secilën tematikë. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, si edhe ndarjen e orëve sipas tematikave. Që nxënësit të aftësohen në këtë lëndë, ata duhet të kenë në dispozicion orë që ju mundësojnë praktikimin e njohurive të reja dhe infrastrukturën e përshtatshme në shkollë.

Zhvillon mendimin kritik se si TIK mund të zgjidh problemet në botën reale dhe rrjedhojat përkatëse

Bazat e kompjuterit

Algoritmika dhe programimi

Bazat e të dhënave dhe menaxhimi i tyre

Transmetimi i të dhënave, rrjetat dhe Internet-i

Zhvillimi i aplikacioneve, software-ve dhe sistemeve

Mendimi kompjuterik: zbërthimi, njohja e modeleve, abstraksioni, mendimi algoritmik

### Ndarja kohore në secilën klasë

Klasat	Nr. i orëve vjetore	Bota e kompjuterit (hardware) (software)	Përpunimi digjital i të dhënave	Programimi në Ueb / JAVA	Algoritmikë dhe programim	Bazat e të dhënave dhe menaxhimi i tyre	Transmetimi i të dhënave, rrjetat dhe Interneti	Zhvillimi i aplikacioneve, softeve dhe sistemeve
Klasa 10-të	<b>72 orë</b>	10 orë	17 orë	16 orë ueb dhe 7 orë java	22 orë			
Klasa 11 / Bërthamë	<b>36 orë</b>	6 orë	6 orë	8 orë ueb dhe 4 orë java	12 orë			
Klasa 11 / TIK avancë	<b>36 orë</b>			Java 9 orë Adobe Flash 9 orë	9 orë algoritmë 9 orë nocione të programimit			
Klasa e 12-të	<b>68 orë</b>	10 orë			18 orë	14 orë	12 orë	14 orë

## **2. Modele të zhvillimit të kompetencave kyçe nëpërmjet lëndës**

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme të procesit të nxënies. ***Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies.*** Kompetenca demonstron nga nxënësi (njohuri), bazohet në performancën e tij (aftësi), si dhe bazohet në perspektivën e sjelljes (qëndrim). Organizimi i mësimin të TIK-ut me bazë kompetencat përqendrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën. Në këtë pjesë të udhëzuesit ne do të japim tri shembuj konkret se si nëpërmjet një tematike në lëndën e TIK-u, mësuesit mund të vlerësojë nxënësin edhe në kompetencat e tjera kyçe.

### **Kompetencat e fushës**

Vazhdimësia e aftësisë TIK të të mësuarit është e organizuar në pesë kompetenca të fushës të ndërlidhura:

- Zbatimi i protokolleve dhe praktikave sociale dhe etike kur përdorin TIK-un.
- Hetimi me TIK.
- Krijimi me TIK.
- Komunikimi me TIK.
- Menaxhimi dhe veprimi me TIK.



**Rezultatet e të nxënit për secilën kompetencë në lëndën e TIK-ut dhe shembuj se si ato lidhen me kompetencat kyçe.**

	<b>Kriteret e performancës</b>	<b>Klasa X</b>	<b>Klasa XI</b>	<b>Shembuj</b>
<b>Hetimi me TIK: Kompetenca e të menduarit dhe e të nxënit</b>	<i>Hetojnë dhe bëhen konsumatorë kritikë të informacionit.</i>	<p><b>Nxënësit :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-zhvillojnë një pamje ueb për website-n e tyre në vijim të strategjive të hulumtuara;</li> <li>-planifikojnë dhe paraqesin kërkime me bibliografi të shënuar;</li> <li>-analizojnë burime informacioni elektronike, kritikojnë besueshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre.</li> </ul>	<p><b>Nxënësit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-hartojnë një website motor dhe përmirësojnë renditjet e motorëve të kërkimit;</li> <li>-marrin në konsideratë burimet parësore dhe dytësore të kërkimit kur citojnë bibliografitë;</li> <li>-vetëvlerësojnë burimet e veta të informacionit të tilla si website dhe blogje, duke kritikuar besueshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përdorin qëndrimet logjike të tilla si e vërtetë / e rreme , kërkojnë brenda fushave për llojin e të dhënave.</li> <li>-Përdorin pajisje data <i>logger</i>, mikroskop dixhital , përdorin modele digjitale për të provuar dhe për të përshtatur hipotezat për zgjidhjen e problemave.</li> </ul>
	<i>Hetojnë duke përdorur strategjitë dhe mjetet e duhura.</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-bashkëpunojnë për të zgjidhur problemin dhe konkurrojnë me të tjerët në lojërat interaktive edukative;</li> <li>-punojnë me një komunitet online për të arritur një qëllim të përbashkët kërkimor duke marrë parasysh përgjegjësinë për të integruar të gjithë anëtarët e komunitetit;</li> <li>-demonstrojnë njohuri për sistemet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-reflektojnë mbi rezultatet e një loje interaktive edukative ;</li> <li>-identifikojnë strategjitë për sukseset e ardhshme;</li> <li>-krijojnë dhe punojnë me një komunitet online për hulumtim reciprok;</li> <li>-aplikojnë njohuritë e fituara përmes zgjidhjes së problemit në një mjedis simulimi të një konteksti të jetës reale .</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Krahasojnë të dhënat objektive nga burime të shumta digjitale për të vlerësuar mundshëm besueshmërinë e informacionit të dhënë.</li> <li>-Përdorin wikis ose dokumente të tjera të përbashkëta, kërkojnë baza të dhënash.</li> </ul>

		komplekse pas zgjidhjes së problemit në to si dhe në mjediset stimuluese .		
Krijimi me TIK: Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin	<i>Krijojnë, redaktojnë dhe ndajnë informacion dhe ide.</i>	-krijojnë, promovojnë dhe paraqesin një transmetim për një audience të gjerë;  -bashkëpunojnë për të planifikuar dhe prezantuar një produkt digjital të rafinuar teknikisht që integron aplikime të përshtatshme të TIK-ut; -marrin përgjegjësinë për redaktimin e një elementi të një produkti digjital të prodhuar në bashkëpunim.	-krijojnë produkte media komplekse, bindëse dhe shumë të individualizuara;  -zgjedhin, integrojnë dhe vlerësojnë elemente dhe mjete të projektimit për potencialin e tyre për të arritur efektet e dëshiruara;  -demonstrojnë përvoja të specializuara digjitale redaktimi.	- Përdorin softuerë për të krijuar hiperlinke, tabela dhe skema. Përdorin softuerë për hartimin dhe planifikimin e projekteve.
	<i>Bazohen në konventat e njohura për të shprehur ide dhe informacion.</i>	-menaxhojnë dhe organizojnë të dhëna duke përdorur mjete të tilla si mail merge; -mbajnë një koleksion të gjerë të produkteve digjitale që përputhen me konventat e prezantimit të TIK-ut;  -përshkruajnë idetë e tyre krijuese dhe hartojnë raportin e tyre në lidhje me pronësinë intelektuale.	-përzgjedhin dhe përdorin sisteme menaxhimi të dhënash të përshtatshme për kërkesa specifike; -diskutojnë të ardhmen e projektimit të produkteve digjitale;  -shpjegojnë se si të sigurojnë të drejtat ligjore të pronësisë dhe se si të mbrojnë të drejtat e pronësisë intelektuale.	Modelojnë zgjidhje në spread sheets, krijojnë filma, animacione, website dhe muzikë, programojnë lojëra, përdorin bazë të dhënash, krijojnë faqe ueb-i për përdoruesit me aftësi të kufizuara në shikim, përdorin funksione të avancuara për të menaxhuar dhe redaktuar produkte digjitale për efektet e dëshiruara.
kompetenca e komunikimit dhe	<i>Shprehin identitetin, komunikojnë në mënyrë të</i>	-promovojnë respekt për veten dhe të tjerët në komunikime; -diskutojnë sfidat	-identifikojnë mënyrat e TIK-ut që mund të përdoren për të promovuar të	- Përdorin aplikacione online dhe mjetet e menaxhimit për projekte bashkëpunuese të tilla si portalet online, wikis;

	<i>përshatshme dhe ruajnë sigurinë dhe privatësinë.</i>	<p>në lidhje me shfaqjen, parandalimin dhe kontrollin e krimit kibernetik;</p> <p>-kuptojnë shqetësimet e paraqitura nga rrjete të veçanta online.</p>	<p>drejtat e njeriut;</p> <p>-demonstrojnë mirëkuptim të legjislacionit të krimit kibernetik;</p> <p>-krahasojnë dhe vlerësojnë se si rrjete të ndryshme online mbrojnë identitetin .</p>	<p>përdorin mjetet e përbashkëta të rrjeteve sociale për qëllimet strategjike.</p> <p>- Kuptojnë avantazhet dhe disavantazhet e përdorimit të website-ve dhe mjediseve online për menaxhim dhe bashkëpunim.</p>
	<i>Kontribuojnë dhe mësojnë nga të tjerët.</i>	<p>-planifikojnë një projekt këmbimi online, e zbatojnë atë dhe tërheqin pjesëmarrësit në të;</p> <p>-zgjedhin dhe rekomandojnë zgjidhje softuerë bashkëpunuese të përshatshme për qëllime të veçanta;</p> <p>-bëjnë rekomandime për përdorimin etik të pajisjeve të reja.</p>	<p>-lehtësojnë punën në grupe me softuerë dhe bashkëpunojnë për të gjetur mjete për menaxhim projekti;</p> <p>-krahasojnë dhe vlerësojnë teknologjitë e reja për ndikimin ndaj çështjeve që ata paraqesin.</p>	
<b>Menaxhimi dhe Operimi me TIK : Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b>	<i>Përdor procedurat e njohura për të mbajtur një mjedis TIK të sigurt, të mbrojtur dhe efikas.</i>	<p>-përshkruajnë rreziqet specifike të sistemit të tilla si: mosfunksionimi i celularit dhe se si t'i heqin ato ;</p> <p>-krahasojnë sistemet e përbashkëta të lidhjes të tilla si dial-up, ADSL, Wireless Broadband;</p> <p>-analizojnë dhe krahasojnë përgjegjësinë e TIK duke përdorur politikat e organizatave të ndryshme.</p>	<p>-demonstrojnë njohuri dhe kuptojnë të rejat e fundit të sigurisë TIK;</p> <p>-diagnostikojnë defektet kompjuterike, i riparojnë ato dhe përmirësojnë sistemet;</p> <p>-sigurojnë të informohen më këshilla për shëndetin dhe për sigurinë TIK-ut në mjedise specifike.</p>	<p>- Zgjedhin opsionin e duhur për krijimin e një faqeje interneti të tillë si një mjet online ose editor HTML.</p> <p>- Ndryshojnë toolbars.</p> <p>- Klasifikojnë dhe paraqesin funksionet;</p> <p>- Përdorin printimin duplex.</p> <p>- Përdorin filtra për të devijuar postën e padëshiruar.</p> <p>- Optimizojnë funksionet dhe tiparet e mjeteve online për një qëllim të caktuar.</p>

	<p><i>Kuptojnë se si sistemet dhe komponentët TIK janë përdorur për të ruajtur dhe rifituar informacionin.</i></p>	<p>-bëjnë dallimin ndërmjet funksioneve të sistemeve operative softuerë dhe aplikacioneve softuerë;</p> <p>-përshkruajnë tiparet kryesore të rrjeteve të një sistemi operativ të tilla si kontrollin e aksesit, shërbimet e dosjeve dhe shkëmbimi.</p>	<p>-demonstrojnë menaxhim efikas dhe efektiv të skedarëve;</p> <p>-kuptojnë se si një kompjuter kryen logjikën digjitale (duke përdorur sistemin e numrave binarë);</p> <p>-marrin pjesë në hartimin dhe ndërtimin e rrjetit.</p>	<p>-Hartojnë dhe përdorin konvencione file/folder të qëndrueshme me emërtime.</p> <p>- Mirëmbajnë versionin e kontrollit të dokumenteve.</p> <p>- Kufizojnë aksesin e të dhënave nga lokacioni ose fjalëkalimi.</p> <p>-Zbatojnë njohuritë e tij për të vendosur nëse do të përdorë cloud, server lokal ose storage; nëse do të përdorë webcam apo kamera digjitale.</p>
<p><b>Zbatimi i protokolleve dhe praktikave sociale dhe etike kur përdorin TIK-un.</b> <b>Kompetenca personale dhe kompetenca qytetare</b></p>	<p><i>Njohin pronësinë intelektuale dhe aplikojnë praktika të sigurisë së informacionit digjital.</i></p>	<p>-identifikojnë dhe përshkruajnë dilemat etike ;</p> <p>-përdorin një sërë strategjish për sigurimin dhe mbrojtjen e informacionit.</p>	<p>-në mënyrë të ndërgjegjshme aplikojnë praktika që mbrojnë pronësinë intelektuale;</p> <p>-vlerësojnë rreziqet që lidhen me mjediset online dhe krijojnë strategji të përshtatshme të sigurisë dhe kodeve të sjelljes.</p>	<p>-Kuptojnë se piratimi u mohon muzikantëve pagesën për punën e tyre.</p> <p>-Kuptojnë licencimin e krijimeve të përbashkëta.</p> <p>-Përdorin parametrat komplekse të sigurisë për faqet online.</p> <p>-Ndryshojnë fjalëkalimin e strukturave.</p> <p>- Ndajnë informacionin me dosjet apo faqet dhe kuptojnë se si të modifikojnë parametrat e parazgjedhura brenda faqeve e rrjeteve sociale.</p>

	<p><i>Aplikojnë protokollet personale të sigurisë dhe identifikojnë ndikimin e TIK-ut në shoqëri.</i></p>	<p>-në mënyrë të pavarur aplikojnë strategjitë e duhura për të mbrojtur të drejtat, identitetin, jetën private dhe sigurinë emocionale të tjerëve gjatë përdorimit të TIK-ut;</p> <p>-vlerësojnë ndikimin e TIK-ut në vendin e punës dhe në shoqëri.</p>	<p>-diskriminojnë mes protokolleve të përshtatshme për mjete të ndryshme të komunikimit kur bashkëpunojnë me komunitetet lokale dhe globale;</p> <p>-diskutojnë për rolin e TIK-ut në të ardhmen dhe se si ata mund të ndikojnë në përdorimin e tij.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Analizojnë pasojat e mundshme të postimit të informacionit personal në faqet e rrjeteve sociale.</li> <li>- Marrin përgjegjësinë për efektin e komunikimit të tyre me njerëzit e tjerë.</li> <li>- Përdorin përshëndetjet e duhura.</li> <li>- Rregullojnë gjatësinë dhe formalitetin e mesazhit që të përshtatin formën e komunikimit.</li> <li>- Njohin rritjen e potencialit të përfshirjes për njerëzit me aftësi të kufizuara nëpërmjet TIK-ut, ndarja dixhitale, llojet e reja të punës, globalizimi.</li> </ul>
--	---	--	--	---

### **3. Modele të integritit ndërlëndor brenda dhe jashtë fushës së të nxënit**

TIK-u luan një rol të rëndësishëm në të gjitha fushat e tjera. Ai u shërben të gjitha fushave, duke pasuruar situatat e mësimi në të cilat nxënësi zhvillon kompetencat e tij. Përdorimi i teknologjisë ndihmon në përvetësimin më mirë të lëndëve të tjera nga nxënësi duke i bërë ato më të kuptueshme dhe më tërheqëse. Përdorimi i TIK-ut duhet të shihet si një mjet që i ndihmon nxënësit të përqendrohen më gjatë në klasë. Është shumë e rëndësishme që mësuesit e lëndëve të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në mënyrë që nxënësit të kenë mundësinë të krijojnë lidhje analoge midis lëndëve. Madje propozohet që disa projekte kurrikulare të jenë të përbashkëta për disa lëndë. Në këtë mënyrë do të ulej ngarkesa e nxënësve por edhe ata do të aftësoheshin për të zgjidhur një problem nëpërmjet përdorimit të njohurive nga fusha të ndryshme.

<b>Lëndët</b>	<b>Shembujt konkret se si lidhet TIK me lëndët</b>
<b>Artet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Nxënësit hyjnë në një faqe ueb që publikon video si p.sh: You Tube (<a href="http://www.youtube.com">www.youtube.com</a>). Vendosin 5 video kërcimi në një listë dhe vlerësojnë çdo kërcim duke vendosur yje. Reagojnë me komente të përshtatshme kritike për çdo klip. Planifikojnë një kërcim në grup. Nën kujdesin e mësuesit kryejnë dhe ngarkojnë kërcimin. Diskutojnë komentet e marra me kalimin e kohës për të përmirësuar performancën në të ardhmen.</li> <li>✓ Viziton një studio virtuale muzikore p.sh. BBC One Music (<a href="http://www.bbc.co.uk/radio1/onemusic/studio/">www.bbc.co.uk/radio1/onemusic/studio/</a> ). Bën muzikë në një sekuenciator. Shqyrton punime të ndryshme në industrinë e muzikës.</li> <li>✓ Të bëjnë një përmbledhje video të valleve të realizuara nga nxënësit e klasës. Të konsultohen online me “Udhëzues të zgjidhjes së problemeve të videove digjitale” pas kryerjes së një kërkimi dhe ndjekjes së këshillave të tij kur problemet dalin dhe të përpunojnë videon.</li> <li>✓ Të bëjë një reklamë për një seri të re produktesh imagjinare që promovojnë mjedis TIK të sigurt, të shëndetshëm dhe komod. Në grupe krijojnë modele të produkteve të paraqitura, një tingull dhe video reklamë. Shikimi i reklamave të prodhuara nga grupet e tjera. Shqyrtojnë kritikën e ndërsjella të reklamave për të rritur aftësitë e tyre që të bindin konsumatorin që të blejë produktet.</li> </ul>
<b>Letërsia</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Zgjedhin një temë me interes. Kërkojnë në Wikipedia artikuj që kanë lidhje me temën (<a href="http://www.wikipedia.org/">www.wikipedia.org/</a>) Zgjedhin disa nga informacionet dhe në mënyrë kritike analizojnë ato. Vlerësojnë faktet e paraqitura dhe komentojnë në lidhje me saktësinë, paragjykimin apo autoritetin e tyre. Redaktojnë artikullin e wikipedia-s nëse kërkohet. Diskutojnë pro dhe kundër ndërtimit të bashkësisë së njohurive.</li> </ul>
<b>Shoqëria dhe mjedisi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Shfletojnë artikuj shëndetësorë në faqe me përmbajtje sociale ku informohen me të rejtat e fundit dhe më të njohura të shëndetit. Regjistrohen si përdorues dhe votojnë artikullin e tyre më të preferuar</li> </ul>

	<p>për shëndetin. Diskutojnë pikëpamjet e tyre rreth artikujve me nxënësit e tjerë të klasës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Hartojnë një projekt për mbledhjen e informacionit rreth nxënësve me sjellje të mirë në mjediset online. Studiojnë një grup. Prezantojnë të dhënat e mbledhura Arsyetojnë mbi të dhënat për të identifikuar dhe rekomanduar objektivat e përmirësimit të grupit.</li> <li>✓ Zhvillojnë disa njoftime në gazetën ose në website-in e shkollës për të njoftuar prindërit për krimin kompjuterik dhe përshkruajnë hapat që ata duhet të marrin për të mbrojtur veten dhe familjarët.</li> <li>✓ Hulumtojnë viruset e aparateve telefonike celulare dhe shkruajnë një ese ku përshkruajnë llojet e viruseve mobile aktuale. Shpjegojnë se si ju mund të mbron pajisjen tuaj celulare.</li> </ul>
<b>Matematikë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Përdorin programin (Geometer's Schatchpad) për të ndërtuar dhe ndryshuar figurat gjeometrike dhe zbuluar lidhjet dhe teoremat.</li> <li>✓ Eksplorojnë mjete online (<a href="http://www.explorelearning.com/">www.explorelearning.com/</a>) për të përdorur simulimet online për pyetjet matematikore.</li> <li>✓ Hulumtojnë dhe krahasojnë rritjen e faqeve të rrjeteve sociale të ndryshme. Paraqesin një tabelë Excel (spreadsheet) për të ilustruar krahasimin e rritjes.</li> <li>✓ Bëjnë një produkt digjital për të prezantuar dhe shpjeguar sistemin numerik binar.</li> <li>✓ Analizojnë dhe përshkruajnë një gjuhë programimi popullore. Bëjnë një historik të shkurtër se për çfarë ajo është dizajnuar. Përshkruajnë kodin e burimit, algoritmet e specializuar dhe logjikën formale brenda saj. Diskutojnë për rëndësinë e njohjes së gjuhëve të programimit.</li> </ul>
<b>Shkencat natyrore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Kryejnë një projekt mjedisor me temë të caktuar p.sh:” Ndotja dhe mjedisi”. Përdorin burimet digjitale të ndryshme për realizimin dhe prezantimin e tij.</li> <li>✓ Rekomandojnë një zgjidhje për transferimin, ruajtjen, paraqitjen dhe arritjet e një projekti të përfunduar shkencor. Konsiderojnë hard drive-rin, pajisjet e dorës dhe zgjidhjet online. Cila zgjidhje siguron</li> </ul>

	<p>magazinin të sigurt, rikthim të lehtë për ndarjen, përshkrimin e përmbajtjes, datën e krijuar dhe përdorimin minimal të hapësirës.</p> <p>✓ Krijojnë produkte digjitale me imazhe dhe tekst që tregojnë marrëdhënien midis shkencave kompjuterike dhe ndërveprimit. Përshkruajnë se si ndërveprimi nxit inovacionin dhe rrit produktivitetin.</p>
--	--

#### 4. Metodologjia për zhvillimin e lëndës

Planifikimi i punës mësimore dhe procesi i mësimdhënies është një moment/fazë e cila kërkon ti japë njohuritë e duhura nxënësit, ti nxisë nevojat e tyre, interesat dhe mënyrat e tyre të mësuarit. Procesi mësimor do të ketë rezultate pikërisht nëse nxënësit janë të nxitur për të nxënë dhe ku secili nxënës mëson sipas një mënyre të caktuar apo të njohur në literaturën pedagogjike si *stile të të nxënësit*. Disa nxënës mësojnë përmes *perceptimit*, të tjerë mësojnë duke *analizuar apo reflektuar*, disa përmes *të parit dhe të dëgjuarit*, disa mësojnë vetëm, të tjerë mësojnë në grupe, disa mësojnë në tërësi përmbajtjen mësimore, ndërsa të tjerë e ndajnë atë në pjesë më të vogla logjike.

Krahas këtyre përcaktimeve të të nxënësit, janë mësimdhënësit të cilët gjatë përdorimit të strategjive dhe metodave në procesin mësimor, nxjerrin në pah artin dhe mjeshtërinë e tyre, por edhe vënë në zbatim, përmes stileve të të nxënësit këto metoda.

Mësimdhënës të caktuar përdorin më shumë demonstrimin, të tjerë ligjërimin, reflektimin, diskutimet, por ka të atillë që përqendrohen më shumë në të menduarit, te kujtesa, në të kuptuarit. Për të arritur suksese në procesin mësimor duhet patjetër që mësimdhënësi t'i zbatojë stilet e të nxënësit, duke njohur më parë mënyrat se si mësojnë nxënësit, pikëmbështetje për planifikimin e punës mësimore, përputhshmërisë së stileve të të nxënësit dhe përdorimit të metodave apo teknikave të mësimdhënies në varësi të stileve të përdorura.

Për të siguruar përdorimin efektiv të TIK-ut mësuesit duhet :

- Të planifikojnë përdorimin e TIK-ut nga ana e nxënësve në bashkëpunim me mësuesit e lëndëve të tjera;
- Të planifikojnë saktë temat e reja, për të cilat mund të përdoret TIK-u jo vetëm si aftësi kryesore por edhe si aftësi që ndihmon në arritjen e dijeve në lëndët e tjera;



- Të jenë të sigurt se burimet e TIK-ut janë në dispozicion për mësimdhënien dhe mësimxënien;

Është e rëndësishme që kur bëhet planifikimi i përdorimit të TIK-ut për temat e reja, të sigurohemi më parë që nxënësit janë në gjendje ta përdorin atë.

Përdorimin e Tik-ut si mjet në orën e mësimit mund ta shohim në disa raste siç po i përshkruajmë më poshtë:<sup>1</sup>

#### 1. *Një orë mësimi në laboratorin e kompjuterëve*

Në një laborator kompjuterësh ku mësimi zhvillohet me ndihmën e teknologjisë, nxënësit rrinë para kompjuterëve dhe zhvillojnë veprimtaritë e tyre individuale si: përdorimi i programeve të ndryshme, kërkimi në internet, shkrimi i letrave dhe dërgimi i tyre elektronikisht, punime apo detyra individuale apo bashkëpunim online mes nxënësish. Nëpërmjet kësaj metode realizohet mësimi individual si dhe komunikimi online.

#### 2. *Një orë mësimi në një klasë me disa kompjuter*

Në klasat me disa kompjuter mund të kryhen disa veprimtari. Në këto lloj klasash të organizuara në grupe me nga tri- katër nxënës, komunikimi mësues-nxënës realizohet më lirshëm mes tyre. Ndryshe nga laboratori, nxënësit kanë mundësi të punojnë pa kompjuterin dhe të përdorin atë vetëm kur u duhet ose nëse u duhet. Në këtë mjedis teknologjia shërben si mjet për të zgjidhur llojet e të gjitha detyrave që nga krijimi i faqeve të internetit deri në krijimin e portofolëve personale. Në këto klasa mësuesit mund tu japin nxënësve detyra të cilat bëhen me ndihmën e kompjuterit, duke bashkëpunuar me shokët e klasës ose nëpërmjet shkëmbimeve online.

#### 3. *Një orë mësimi në klasa me një kompjuter*

Në disa shkolla ka klasa të cilat janë të pajisura me një kompjuter. Një kompjuter mund të duket i pamjaftueshëm për orën interaktive, por zhvillimi i mësimit me një kompjuter ka disa përparësi:

- Mësuesi menaxhon veprimtarinë e nxënësve në çdo moment;
- Mësuesi kontrollon lehtësisht veprimtarinë e nxënësve duke i udhëzuar ata;
- Teknologjia është në dispozicion në momentin e duhur;
- Nxënësit mund të shohin njëri-tjetrin dhe të bashkëpunojnë lirshëm ;

<sup>1</sup> Universiteti Sh.Kirili Fakulteti Pedagogjik, Shkup, fq. 16

- Duke pasur vetëm një kompjuter në klasë, vëmendja zhvendoset nga teknologjia në mësim nëpërmjet bashkëpunimit;

Përdorimi i Tik-ut në mësim rrit cilësinë e mësimdhënies, paraqet një strategji mjaft të rëndësishme për asimilimin e njohurive dhe ofron mundësi për përmirësimin e sistemit arsimor.

Për këtë arsye, rekomandohet aplikimi i metodave të reja të mësimdhënies dhe nxënies duke integruar TIK-un në proces vetëm në orët kur shikohet e arsyeshme. Për të realizuar orë të tilla nevojiten këto pajisje:

- Kompjuter
- Printer
- Video projektor
- Rrjete kompjuterike lokale
- Instalim interneti
- Softuerë/portail për të gjitha lëndët që dëshirojnë të përdorin TIK-un
- Laboratorë virtual....etj..

Në këto cikle shkollimi është shumë i rëndësishëm fakti që jo të gjithë nxënësit mësojnë njësoj. Për këtë arsye, në këtë kapitull i japim rëndësi inteligjencave të shumëfishta që ndikojnë në përvetësimin e njohurive nga ana e nxënësve.

#### **4.1 Inteligjencat e shumëfishta**

Howard Gardner ka propozuar një teori për inteligjencat e shumëfishta (Tabela 4.3), dhe mësuesit në çdo nivel klase.

Ai sugjeron që inteligjenca i referohet aftësisë së njerëzve për të zgjidhur problemet ose për të bërë diçka të vlerësuar në një kulturë të caktuar (Checkley, 1997). Në librin e tij *Frames of Mind* (1983), Gardner, propozon që kultura jonë ka për ta përcaktuar ngushtë inteligjencën dhe që faktikisht ka të paktën shtatë inteligjenca bazike. Teoria e tij njihet si teoria e inteligjencave të shumëfishta (teoria MI). Gardner gjithashtu sugjeron që inteligjenca ka të bëjë më tepër me kapacitetin për të zgjidhur probleme dhe për ti dhënë formë produkteve se sa me detyrat e izoluara të testeve të IQ.

Armstrong (1994, fq. 11, 12) sugjeron katër pika kyçe në teorinë MI (multiple inteligjencis):

1. Çdo person posedon plot tetë inteligjenca. Disa njerëz kanë nivel të lartë të funksionimit të pjesës më të madhe të inteligjencave: disa të tjerë janë më të zhvilluar në një ose dy inteligjenca dhe më modest ose më pak të zhvilluar në inteligjencat e tjera.
2. Pjesa më e madhe e njerëzve mund të zhvillojnë secilën inteligjencë në një nivel të përshtatshëm kompetence.
3. Inteligjencat zakonisht veprojnë së bashku në mënyra komplekse. Inteligjencat ndërveprojnë dhe mbështesin njëra tjetrën.
4. Ka shumë mënyra për të qenë inteligjent në secilën kategori. Nuk ka një set standard karakteristikash, cilësish, ose attribute që një person duhet të ketë për të qenë inteligjent në një fushë të caktuar.

Gardner nuk mbron një mënyrë të vetme të mësimi dhe nuk beson se ka një plan për mësimdhënien (Checkley, 1997). Ai beson që teoria MI, mbasi kuptohet, inkurajon mësuesit të marrin parasysh ndryshimet individuale dhe ti ndihmojnë të gjithë fëmijët ta përdorin mendjen e tyre mirë (Checkley, 1997). Për aplikimin e modelit MI në klasë, mësuesit largohen nga format tradicionale të mësimdhënies, duke përfshirë shpjegimin dhe kërkimin nga studentët për detyra të shkruara dhe punime. Në termat e vlerësimit Gardner mbron idenë që mësuesit duhet të lejojnë nxënësit të demonstrojnë të kuptuarin në një shumëllojshmëri mënyrash (Checkley, 1997).

Kur mësuesit aplikojnë modelin MI në mësimdhënien e tyre, sugjerohet që ata të mendojnë për inteligjencat dhe se si ato mund të integrohen në mënyrën e duhur në një kapitull ose mësim të veçantë, duke mundësuar një balancë ndërmjet tetë inteligjencave në aktivitete. Duke vepruar kështu, të gjithë nxënësit mund të kenë inteligjencën e tyre më të fortë të përfshirë disa herë në kohë. Armstrong (1994, fq. 58) sugjeron që, nëse njëherë të vetme objektivi i një kapitulli ose mësimi është në mendje, mësuesit mund të bëjnë pyetjet e mëposhtme për të adresuar tetë inteligjencat:

- 1. Logjike- Matematikore:** Si mund të paraqes numrat, llogaritjet, klasifikimet logjike ose të menduarin kritik?
- 2. Gjuhësore:** Si mund ta përdor fjalën e shkruar apo të lexuar?
- 3. Hapësinore:** Si mund ta përdor ndihmën vizuale, vizualitetin, ngjyrat, artin apo metamorfozën?

**4. Muzikore:** Si mund të paraqes muzikën ose tingujt e ambientit, ose të caktoj pika kyçe në një ritëm ose strukturë melodike?

**5. Trupore-Kinesthetic:** Si mund të përfshij të gjithë trupin ose përdor eksperiencat konkrete?

**6. Natyraliste:** Si mund ta përdor ambientin jashtë?

**7. Ndërpersonale:** Si mund ti angazhohj studentët në shkëmbimin në çift, mësimin bashkëpunues ose simulimet në grupe të mëdha?

**8. Intrapersonal:** Si mund tu shkaktoj ndjenja personale apo kujtime ose tu jap studentëve mundësi zgjedhjeje?

Duke marrë në konsideratë për sa i përket më lart, disa teknika interaktive që mund të përdorin mësuesit në lëndën e TIK-ut janë :

### ***Brainstorming (stuhi mendimesh)***

---

Brainstorming (stuhi mendimesh) është një teknikë, e cila u kërkon nxënësve të mendojnë rreth një çështje dhe të diskutojnë rreth saj me synim ndërtimin e njohurive të reja. Kjo teknikë, siguron një mjedis të lirë dhe të hapur që inkurajon të gjithë pjesëmarrësit për të shprehur në mënyrë kreative mendimet e tyre rreth një problemi. Teknika (brainstorming) përdoret në fazën fillestare të ndërtimit të njohurive të reja. Në këtë fazë, mësuesi udhëzon nxënësit të listojnë të gjithë njohuritë që ato kanë lidhur me temën e re. Në këtë fazë, roli i mësuesit është të drejtojë debatin, të kuptojë mendimet e nxënësve dhe të dëgjojë me kujdes idetë e tyre. Përdorimi i kësaj teknike synon pjesëmarrjen aktive të nxënësve në procesin mësimor. Brainstorming është një teknikë e thjeshtë dhe e efektshme e cila kërkon një nivel të lartë krijimtarije për tu përdorur. Këtë teknikë mësuesit e TIK-ut mund ta përdorin gjatë kohës që ata zhvillojnë kryesisht tematikën e Internetit si dhe atë të prezantimit digjital. Gjithashtu mësuesit gjatë tematikës së prezantimit digjital, mund tu kërkojë nxënësve të realizojnë prezantime duke përdorur programe të ndryshme multimediale dhe më pas tu kërkojë nxënësve se nga ndryshojnë ato nga njëri-tjetri.

### ***Harta e koncepteve (Konceptograma)***

---

Harta e koncepteve (konceptograma), është një metodë (teknike) e paraqitjes vizuale të një informacioni dhe shërben për lidhjen e koncepteve të një teme mësimore, disa temave apo të një


tematike. Përcaktimi me saktësi i kësaj metode (teknike,) mundëson qëndrueshmëri në përvetësimin e njohurive, integrimin logjik dhe aftësinë për zbatimin e tyre, si dhe shprehinë e një pune krijuese. Konceptograma shërben si një instrument diagnostikues i procesit të të nxënit interaktiv. Konceptogramën mund ta ndërtojmë edhe duke filluar nga një koncept specifik dhe të kalojmë te koncepti themelor. Ato mund të jenë dy llojesh: të thjeshta, ose të detajuara në degë hierarkike. Elementët përbërës të tyre janë: etiketat, vijat dhe nyjat.

Në etiketa vendosen konceptet, vijat lidhin konceptet dhe përcaktojnë tipin e strukturës së konceptogramës.

Konceptograma zbatohet lehtë në kushtet e mjedisit të një klase. Mësuesi udhëzon nxënësit hap pas hapi duke mbajtur shënime në tabelë dhe pasi dëgjon mendimet e tyre, bën vërejtjet përkatëse dhe ndërton një konceptogramë, duke u bazuar në idetë më të mira të nxënësve. Më poshtë po listojmë veprimet që kryen mësuesi gjatë një ore mësimore:


- Mësuesi liston në një tabelë përmes diskutimit me nxënësit të gjitha konceptet që përmban tema apo tematika.
- Ai ndërton së bashku me nxënësit diagramin e konceptogramës duke vendosur konceptet në etiketa.
- Vendos konceptin më të përgjithshëm në qendër dhe e rrethon atë.
- Pyet nxënësit se cilat janë konceptet e tjera, që lidhen me konceptin e vendosur te etiketa qendrore.
- Bashkon etiketat me vija të thjeshta ose vija me shigjeta sipas kontekstit të përmbajtjes së tyre.
- Mund të udhëzojë nxënësit që të ndarë në grupe të ndërtojnë secili nga një konceptogramë. Në fund të kohës së caktuar, mësuesi kontrollon konceptogramet dhe ndërton një konceptogramë duke debatuar dhe bërë komentet e duhura me nxënësit për problematikat ose logjikën e ndjekur nga ana e tyre.

Në lëndën e TIK-ut nxënësit e klasës së 10-të deri 12-të mund të krijojnë lehtësisht hartat e koncepteve nëpërmjet programit Prezi, ose nëpërmjet programeve dhe aplikacioneve të specializuara siç është p.sh. : MindVieW.



Gjithashtu nëpërmjet algoritmikës, nxënësve ju kërkohet të zhvillojnë mendimin skematik, në mënyrë që të krijojnë skema për të zgjidhur probleme. Gjithashtu kur ata kodojnë në Java, ata duhet të dallojnë shumë mirë çfarë janë variablat publike dhe cilat janë variablat private. Për këtë atyre u kërkohet të krijojnë njëherë hartën e koncepteve para se të kodojnë të dhënat.

**shpjegimet teorike përkatëse:**



Në këtë skemë mësuesi duhet të bëjë ndarjen e variabëlve para se të fillojë kodimin.

### **Udhëzime për përdorimin e saj në klasë**

- Shkruani në tabelë të gjitha konceptet e reja të një tematike.
- Ndërtoni etiketat, ku në secilën prej tyre keni të vendosur nga një koncept.
- Vendosni etiketat sipas një rregulli logjik.
- Bashkoni me vija konceptet që lidhen me njëri –tjetrin.

---

### ***Debati***

---

Debati është një metodë që karakterizohet nga një procedurë formale për paraqitjen e argumenteve për një çështje, nga dy grupe kundërshtare, para dëgjuesve duke ndjekur një ecuri standard. Njëri prej grupeve është pro problemit, tjetri kundër. Për të zhvilluar një debat është e domosdoshme të kesh një problem, dy skuadra debatuesish dhe një procedurë për të debatuar çështjen. Debati të jep mundësi të flasësh, të pyesësh dhe të përgatitësh argumentet.

Kjo metodë/technikë mund të përdoret në klasë me grupe të mëdha ose të vogla nxënësish. Në të dyja rastet, debati është më mirë të fillojë me anë të një diskutimi të shkurtër të çështjeve të përfshira në temën e debatit. Kjo ofron një kontekst për debat, një kuptim të nën-çështjeve të përfshira, dhe mat dijet që ka klasa rreth kësaj çështje. Në këtë kohë, mësuesi duhet të bëjë të qartë rregullat e debatit, duke përfshirë kohën e caktuar për secilin grup dhe rregullat për të folur. Pasi palët dhe zgjedhja është vendosur, nxënësve do t'ju duhet kohë për të përgatitur argumentet dhe strategjitë e tyre.

Nëse klasa është pro kryerjes së një debati si një grup i madh, atëherë, mësuesi shërben si moderator. Në formate të vogla (*secila skuadër përbëhet nga dy ose tri debatues*) ose grupe të mëdha, nxënësit duhet të udhëzohen të argumentojnë pikëpamjet e tyre pro ose kundër mbështetur në burime, në varësi të objektivave të mësuesit. Mësuesi gjatë zhvillimit të debatit vendos vëzhgues si gjykatës dhe i udhëzon ata si duhet të procedojnë në një debat. Po ashtu vendos vëzhgues të tjerë si matës të kohës. Për ti bërë vëzhguesit sa më aktiv, mësuesi i nxit ata për ti shtuar debatit çështje të tjera të cilat nuk janë prekur nga grupet debatuese.

Debati ka një drejtues, i cili prezanton temën dhe folësit, pasi debate ka mbaruar moderatori mund të drejtojë një diskutim të hapur në të cilin ndjekësit e debatit mund të shprehin mendimet e tyre ose të drejtojnë pyetje.

Debatuesit bëjnë një paraqitje formale dhe argumentojnë çështjen brenda kohë së caktuar.

Ai që shënon kohën (vëzhguesi), kujdeset për respektimin e kohës së përcaktuar për secilin debatues.

Debati është një metodë që përdoret më tepër në shkollën e mesme, ai mund të përdoret edhe si një veprimtari ndërshkollore.

Mësuesi i jep përparësi grupit të nxënësve që përpilon arsyetime të bazuara në prova dhe argumente konkret brenda kohës së përcaktuar.

Disa mësues preferojnë ta përmbledhin debatin në fund, kjo për të sqaruar informacionin e paraqitur që nxënësit të përqendrohen drejtpërdrejt tek pikat kyçe që rrjedhin nga debati.

Mësues të tjerë, përmbledhin kontributet e nxënësve duke ruajtur shumëllojshmërinë e mendimeve dhe perspektivave të cilat dalin gjatë debatit.

### **Udhëzime për përdorimin e saj në klasë**

- Zgjidhet çështja që do të debatohet.
- Ndahet klasa në dy skuadra.
- Drejtuesi paraqet temën e debatit, grupet, atë që do të mbajë shënimin kohën dhe vlerësuesit.
- Secila skuadër bën një paraqitje formale të çështjes brenda kohës së caktuar.
- Secila skuadër kundërshton argumentet e skuadrës tjetër.

### **Tematika për debat:**

- **Gjuhët e programimit: Avantazhet dhe disavantazhet e secilës**
- **Zhvillimi i konceptit të mendimit kompjuterik në ditët e sotme**
- **Me dhe pa kompjuter për të zhvilluar mendimin algoritmik**

### ***Projekte kërkimore***

---

Projekti kërkimor është vlerësuar si metodë tepër pretenduese, realizimi i së cilës kërkon praktikimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: intervista, vrojtimi, studimi rasti, dhe pse jo, kombinimin e të gjitha këtyre teknikave së bashku. Për të realizuar këtë teknikë mësuesi duhet tu lërë nxënësve në dispozicion disa orë mësimore. Kjo teknikë mund tu propozohet nxënësve për realizimin e një projekti lëndor, të cilit mësuesit mund ti lërë në dispozicion disa



orë të periudhës. Nuk duhet që orët të jenë orë që realizohen në klasë, ato mund të jepen në formën e detyrave të shtëpisë. P.sh: kur nxënësit kanë për të trajtuar **temën e Internetit të sigurt**, ata mund të marrin në intervistë nxënësit më të rritur, prindërit apo edhe mësuesit. Më pas të analizojnë të dhënat që do të dalin nga intervistat dhe më pas, duke i diskutuar në klasë, të shohin se sa këto të dhëna përputhen me njohuritë lëndore.

### **Udhëzime për përdorimin e saj:**

- Kërkohe të shfrytëzohet informacioni dhe njohuritë e nxënësit nga më shumë se një lëndë.
- Është metodë që vë në përdorim dhe shfrytëzon përvojat vetjake të nxënësve dhe njohuritë e tyre të marra nga burime jo shkollore.
- Si metodë kërkon që shumë nga veprimtaritë e nxënësve të kryhen jashtë orës së mësimit dhe jashtë mureve të shkollës.
- Projekti kërkimor kërkon përcaktimin e partnerëve pjesëmarrës në arritjen e objektivave. Partnerët mund të jenë mësues të lëndëve të tjera, prindër dhe përfaqësues të komunitetit.

### **Puna me grupe të vogla: Diskutimi në grup si një metodë mësimdhënie:**

- Instruksioni i dhënë për të gjithë klasën ndodh kur mësuesit i paraqesin të gjithë klasës një temë dhe kanë bërë disa ndryshime në përmbajtje ose në vlerësim në bazë të aftësisë personale të çdo nxënësi.
- Qëllimi i instruksionit të dhënë për të gjithë klasën është se të gjithë nxënësit kanë nga një detyrë të përcaktuar për të mësuar përmes së cilës ata fitojnë ose/dhe praktikojnë mësimin.
- Instruksionet duhet të jenë të kuptueshme për të gjithë nxënësit. Niveli i të mësuarit më pas vlerësohet duke përdorur metoda standarde si p.sh. vlerësimi verbal ose joformal.
- **Diskutimi me gjithë grupin** është një formë e modifikuar e mësimdhënies për të transferuar informacion dhe është e përqendruar mbi instruktorin dhe nxënësin.
- Sipas metodologjisë tipike, instruktori ri qëndron përpara klasës dhe i bën një prezantim nxënësve, nga ana tjetër, nxënësit gjithashtu marrin pjesë duke ju përgjigjur pyetjeve dhe duke dhënë shembuj.

## **5. Modele të planifikimit kurrikular të lëndës**

Planifikimi është një proces i rëndësishëm i zbatimit të kurrikulës sepse i krijon mundësinë mësuesit të jetë krijuar dhe i lirë në procesin e mësimdhënies. Për një planifikim të mirë, mësuesi duhet të njohë dokumentet e mëposhtme:

- Kornizën Kurrikulare
- Kurrikulën bërthamë
- Programin mësimor

Baza e një planifikimi të suksesshëm është njohja e mirë e programit mësimor. Mësuesi duhet të zbatojë me përpikmëri të gjitha kërkesat e këtij programi. Rezultatet e të nxënit janë një themel i përbashkët për të gjithë mësuesit. Mësuesit përzgjedhin vetë metodat dhe strategjitë më të përshtatshme, burimet e mundshme për t'u shfrytëzuar, llojet dhe mjetet e vlerësimit.

### **Llojet e planifikimeve. Planifikimi i mësimdhënies për lëndën ose modulën përfshin:**

- Planifikimin vjetor
- Planifikimin për secilën periudhë (shtator-dhjetor; janar-mars; prill-qershor)
- Planifikimin ditor

Në fillim të vitit shkollor, mësuesi duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së shkollës *planin vjetor* të lëndës ose të modulit, i cili shërben si një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orëve mësimore, si edhe *planin e periudhës së parë* (shtator-dhjetor). Planet e periudhës së dytë dhe të tretë dorëzohen para fillimit të secilës periudhë.

Gjatë vitit, sipas rrethanave që i krijohen, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin fillestar mësimor. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë nga sa e ka parashikuar kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi. Në këtë mënyrë mësuesi planifikon duke u bazuar në përparimin e nxënësve dhe në vështirësitë e hasura në periudhat paraardhëse, duke u përqendruar te arritjet e kompetencave kyçe dhe të fushës/ lëndës.

**Planifikimi vjetor i lëndës.** Mësuesi, përveç programit mësimor duhet të njohë tekstin që ka përzgjedhur për atë vit shkollor. Natyrisht, realizimi i programit është qëllimi i vërtetë i mësuesit, kurse teksti mësimor i përzgjedhur është një mjet për ta përbushur këtë qëllim. Kur mësuesi sheh se teksti nuk i ka dhënë vendin e mjaftueshëm përvetësimit të një rezultati të nxëni të programit, ai e plotëson vetë këtë mungesë të tekstit, duke përdorur burime të tjera të nxëni.

***Plani vjetor është një plan sintetik, ku mësuesi planifikon orët dhe përmbajtjen kryesore lëndore për tri periudha. Periudhat e planifikuara përmes planifikimit vjetor janë:***

- 1) Periudha e parë: shtator- dhjetor;
- 2) periudha e dytë: janar – mars;
- 3) periudha e tretë: prill- qershor.

***Shpërndarja e përmbajtjes*** kryesore së lëndës sipas tri periudhave, bëhet në këtë kolonë ku vendosen përmbajtja kryesore e lëndës që do të zhvillohet në secilën periudhë dhe për secilën tematikë. Gjithashtu, vendoset edhe totali i orëve për secilën periudhë, ku përfshihen, njohuri, projekte, përsëritje, punë laborator, biseda letrare, teste etj., në varësi të specifikave të lëndës.

***P.sh.: Planifikimi vjetor*** kryhet duke u bazuar te orët e sugjeruara të kohës së përcaktuar në programin e miratuar, për shembull klasa e 10-të AML.

Klasat	Bota e kompjuterit (harduerë) (softuerë)	Përpunim digjital i të dhënave	Programim në Ueb	JAVA	Programi dhe Algoritmikë	Gjithsej orë
						108orë
Klasa e 10-të	10 orë	17 orë	16 orë	7 orë	22 orë	72 orë

Realizimi i tri llojeve të planifikimit kërkon realizimin dhe të disa rubrikave që përmban program mësimor. Ato janë:

- Ndërtimin e *kompetencave kyçe*.
- Ndërtimin e *kompetencave lëndore*.
- Përfshirjen dhe ndërthurjen e *temave ndërkurrikulare*.
- Përfshirjen dhe ndërthurjen e *fushave/lëndëve* të tjera.

## MODEL PLANI VJETOR

TEMATIKAT	SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS		
	<b>SHTATOR – DHJETOR</b> <b>ORËT = 24 orë</b> Teori = 22 orë, Test = 1 orë Përsëritje= 1 orë	<b>JANAR – MARS</b> <b>ORËT = 24 orë</b> Teori = 21 orë, Test = 1 orë, Përsëritje = 1 orë, Praktikë= 1	<b>PRILL-QERSHOR</b> <b>ORËT = 24 orë</b> Teori = 22 orë, Test = 1 orë, Përsëritje= 1 orë,
<b>BOTA E KOMPJUTERIT 10 orë</b>	1.1 vlerësojnë tipat e ndryshme të kanaleve të transmetimit; 1.2 interpretojnë terminologjinë bazë të kompjuterit; 1.3 njohin komponentët e rrjetit.		
<b>PËRPUNIMI DIXHITAL I TË DHËNAVE 17 orë</b>	2.1 vlerësojnë produktet; 2.2 përdorin wizard-e; 2.3 përpunojnë tekst, muzikë dhe grafikë; 2.4 përdorin organizues grafik dhe storyboard për planifikim; 2.5 njihen me programin FLASH; ..... 2.13 Përsëritje/ punë përmbledhëse/..... 2.14 Test		
		Vazhdon tematika e dytë duke ju përmbajtur orëve që ka në dispozicion në program	
<b>PROGRAMIMI NE WEB 16 orë</b>		<b>Temat mësimore</b>  – kuptojnë mënyrën se si është ndërtuar ueb-i duke u nisur nga shembuj të thjeshtë;  – kuptojnë një tjetër koncept për editimin e tekstit WYSIWG	

		<p>(what you See is What You Get) që përfaqësohet nga programe si Word;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohin platforma të ndryshme komerciale për të krijuar faqet e tyre ueb si DreamWaver, FrontPage, etj.;</li> <li>- mësojnë si integrohet HTML me CSS;.....</li> <li>- Përsëritje/ punë përmbledhëse/orë për portofolin</li> <li>- Test</li> </ul> <p>- Praktikë</p>	
<b>JAVA 7 orë</b>			<ul style="list-style-type: none"> <li>- Teori</li> <li>- mund të jetë përsëritje, orë në dispozicion të portofolit, ose teori sipas nevojës së mësuesit</li> </ul> <p><b>-Test</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Konceptet bazë të <i>Java-s</i></li> <li>- Temë</li> <li>- Temë</li> <li>- Temë</li> <li>- Temë</li> <li>- Ndërtimi i aplikacioneve dhe <i>applet-ve</i> në <i>Java</i></li> </ul> <p><b>- Përsëritje</b></p>

## MODEL PLANI TRE-MUJOR

### PLANIFIKIMI 3-MUJOR (SHTATOR – DHJETOR) KLASA 11-të

**FUSHA: TIK**

**LËNDA: TIK**

**Tematika: Bota e kompjuterit (*hardware, software*)**

**Përshkrimi i tematikës:**

*Nxënësit zhvillojnë aftësitë e tyre, kreativitetin dhe njohuritë në shkenca kompjuterike, mediat digjitale dhe të teknologjisë së informacionit. Identifikimi dhe zgjidhja e problemeve ndërmjet komponentëve kompjuterike dhe bashkëveprimi ndërmjet tyre.*

*Në këtë tematikë, nxënësit/et njihen me nocionin e sigurisë së rrjetit dhe rëndësinë e saj, kërcënimet që vijnë nga interneti, si dhe mënyrat e shmangies së tyre. Gjithashtu, nxënësit/et njihen me termin kriptografi si dhe teknikat e mbrojtjes së rrjetit.*

*Më tej, ata njihen me komponentët e sigurisë së komunikimit si dhe sigurisë ueb, gjithashtu do të mësojnë disa mënyra se si të jenë më të sigurt në rrjet.*

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës**

*Zbatimi i protokolleve dhe praktikave sociale dhe etike kur përdorin TIK*

*Nxënësi:.....*

*- **identifikon ndikimin e TIK-ut në shoqëri:** vlerëson ndikimin e TIK-ut në vendin e punës dhe në shoqëri dhe diskuton për rolin e tij në të ardhmen dhe se si ata mund të ndikojnë në përdorimin e tij.*

*Menaxhimi dhe Operimi TIK:*

**Nxënësi:**

*- **zgjedh dhe përdor hardware dhe software:** argumenton zgjedhjen dhe optimizëm funksionimin e një sërë pajisjesh të zgjedhura dhe funksioneve software për të përfunduar detyra të veçanta, për qëllime të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme shoqërore;*

*- **kupton sistemet TIK:** zbaton të kuptuarit e komponentëve TIK të sistemit të rrjetit për të bërë ndryshime në funksionet, proceset, procedurat*

*dhe pajisjet për të përshtatur qëllimin e zgjidhjes;*

*- **menaxhon të dhënat digjitale:** menaxhon dhe ruan të dhëna të sigurta në disa medime magazinimi dhe formate.*

Nr. Pro g.	Nr.s em/ jave	Kapitulli	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënët	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet	Shënimet
1.	1	Bota e kompjuterit (3 orë)	Siguria e rrjetit dhe rëndësia e saj. Kriptografia	Çfarë masash paraprake duhet të ndërmerren nga një individ, shoqëri, biznes, institucion qeveritar, që të dhënat të mos përdoren nga persona të pa autorizuar, rrjeti që ata përdorin të jetë i sigurt, llogaritë e tyre elektronike?	Metoda interaktive, bashkëvepruese, diskutime, gjithëpërfshirëse; Puna në grup dhe puna individuale;  Hetimi dhe zbulimi;  Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase;  Metoda integruese;  Bashkëbisedim;  Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues;	Vlerësim diagnostikues, intervistë me një listë treguesish; vetëvlerësim me listë kontrolli. Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues) vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësim mes nxënësish; vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë; vlerësimi i detyrave të shtëpisë; vetëvlerësim; intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një listë të plotë treguesish, portofol,	Teksti TIK për klasën XI, pajisje fundore, media; Teksti i mësuesit për klasën XI;  Materiale nga interneti;  Materiale nga enciklopedi;  Tekst nga fusha të tjera;  Slide/materiale të krijuara nga mësuesit;	Orë digjitale
2.	Njohja e sulmeve ndaj rrjetit		Prezantime në forma të ndryshme TIK;  Projekte kurrikulare;	Modele të detyrave nga nxënësit;  Makina llogaritëse etj.				
3.	2		Çfarë mund të bëjmë për të qenë më të sigurt në	Konkurse.				

			internet?					
4.		Përpunimi digjital i të dhënave (9 orë)	Njohuri mbi bazat e të dhënave	Mblidhni informacion nga interneti rreth bazave të të dhënave dhe konceptet e tyre dhe gjeni: 1. karakteristikat kryesore të tyre; 2. historikun e zhvillimit të bazave të të dhënave; 3. përdorimet e tyre në jetën e përditshme.		prezantim me gojë ose me shkrim, projekt kurrikular		Orë digjital e  Orë
5.	3		Njohja me programin ACCESS	Tashmë ju njihni disa nga programet e paketës Microsoft Office. Listoni disa prej tyre. Ç 'mund të thoni për programin Ms. Access 2013? Përse shërben ai? Diskutoni me shokët.				
6.			Llojet e të dhënave dhe çelësi primar	Nëse ju duhet të ndërtoni një bazë të dhënash (BDH) për të regjistruar të gjithë librat që keni lexuar, fillimisht duhet të përcaktoni se çfarë të dhënash duhet të fusni për librin, apo ndryshe, të përcaktoni fushat për bazat e të dhënave që doni të krijoni.				
7.	4		Krijimi i tabelave në MS Access 2013	Ndërtoni një tabelë në Word. Aty listoni librat që keni lexuar dhe për secilin prej tyre zgjidhni fushat për t'i përshkruar sa më mirë. Provoni të ndërtoni të njëjtën tabelë në Access, duke përdorur komandën View te				



				<i>menyja Design. Shpjegoni se cilat janë lehtësitë dhe vështirësitë që hasët për krijimin e tabelave në programin Access.</i>				
8.			Modifikimi i tabelave	<i>Shtoni rreshta të rinj, në tabelën tuaj duke kompletuar listën me libra të rinj që mund të kenë pjesëtarët e tjerë të familjes.</i>				
9.	5		Kërkesat dhe formularët në Ms Access	<i>Secili prej jush ka ndërtuar një bazë të dhënash për librat që ka lexuar. Nëse mbani mend autorin, por jo emrin e librit që keni lexuar, apo të kundërtën, cila është mënyra më e shpejtë për ta kërkuar dhe gjetur atë?</i>				
10.			<b>Projekt</b> (ora e parë). “Integrimi i bazave të të dhënave nga një aplikacion në <i>Vizuale Basic</i> ”	<i>Detyrë krijuese, krijojnë produkte digjitale.</i>				
11.	6		<b>Vlerësimi i portofolit personal</b>					
12.			<b>Test për periudhë</b> (li njat I, II, periudha I)					

## MODEL PLANI DITOR

<b>Fusha: TEKNOLOGJI</b>	<b>TIK Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla: V</b>	<b>Klasa: 10</b>
<b>Tematika 1 Bota e kompjuterit</b> <b>Tema mësimore: Terminologjia dhe funksionimi i kompjuterit</b> <b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Hetimi, mendimi kritik, vendimmarrje: nxënësi krijon dhe zhvillon qëndrime dhe aftësi që do të shërbejnë për përpunimin e informacionit, dallimin midis programeve (software), sigurinë e informacionit.		<b>Situata e të nxënit:</b> Gjatë realizimit të kësaj teme mësuesi hap dritaren e dialogut të My Computer (Computer) ose Control Panel System . Fton nxënësit për të diskutuar për opsionet e skedës Properties, Device Manager. Gjatë këtij diskutimi nxënësit shikojnë parametrat e kompjuterit dhe paraqesin konceptet kryesore në lidhje me temën.	
Fjalët kyçe: Properties, Device Manager, bus, procesor,			
<b>Burimet:</b> Libri mësimor, Materiale nga interneti për procesorin, sistemin e komunikimit Bus, njohuri që ka nxënësi nga përdorimi i komandave të properties dhe device manager.		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Lëndët shkencore, matematikë, fizikë.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>			
Përshkrimi kontekstual i situatës Veprimtaria që kryhet <b>Faza 1:</b> Grupi i diskutimit: Shkruhen në tabelë parametrat e skedave të Properties, Device Manager (mësuesi bashkë me nxënësit njëkohësisht). Çfarë përfaqëson, ku përdoret, pse është e domosdoshme të njihen këto parametra. Plotësohet harta e njohurive në			

mënyrë skematike (bllok-skemë, kllastër, letra ngjitëse).

**Faza 2:** Vëzhgimi-Analiza-Diskutimi: Hapet dritarja e dialogut Properties si dhe një nga kompjuterët për të vëzhguar procesorin dhe tipin e tij. Nxënësit lexojnë dhe komentojnë parametrat e kompjuterit si dhe shikojnë lidhjen midis procesorit dhe HD. Nga interneti kërkojnë tipe të tjera procesorësh dhe i komentojnë ato duke i krahasuar dhe me fotot nga libri.

**Faza 3:** Përfshin të gjithë nxënësit në grup ose individual të provojnë njohuritë që u diskutuan gjatë orës mësimore nëpërmjet krahasimit të procesorëve të librit dhe të gjetur në internet. Mund të bëhet dhe si konkurs ku grupet i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit (f.11-12 ).

Për të realizuar këtë temë, nxënësit përdorin njohuritë që kanë marrë në klasë të 9-të. Informacioni që ata kanë i shërben për t'i përdorur në faza të ndryshme të orës duke zgjedhur ato njohuri që i shërbejnë kontekstit të situatës mësimore. Ato mund të sjellin dhe materiale ndihmëse nga interneti dhe diskutojnë në klasë duke veçuar atë informacion që është i përshtatshëm me temën si procesori, sistemi Bus dhe memoria.

#### **Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen për njohuritë që fitoi gjatë kësaj ore mbi:

- Saktësia e përpunimit të informacionit.
- Rolin dhe funksionimin e procesorit.
- Skemën dhe funksionimit të kompjuterit
- Analizojnë terminologjinë bazë të tij.

#### **Detyrat dhe puna e pavarur:**

Nxënësit ndahen në tre grupe: Secili grup sipas tematikës sjell dhe diskuton informacion shtesë nga interneti.

1. Funksionet e kompjuterit
2. Rolin e procesorit dhe llojet e tyre
3. Memorien dhe performancën e saj.

<b>Fusha: TEKNOLOG- JI/TIK</b>	<b>Lënda: TIK</b>	<b>Shkalla:V</b>	<b>Klasa:XI</b>
<b>Tematika V: Gjuha e programimit JAVA</b> <b>Tema mësimore 1: Krijimi i klasave në Java</b> <b>Tema mësimore2: Vetitë e klasave në Java</b>		<b>Situata e të nxënit1:</b> Krijon një program të thjeshtë në <i>Java</i> , duke zbatuar konceptet e programimit nga klasa (class). <b>Situata e të nxënit2:</b> Llojet e variabëlve; rregullat shkrimit të variabëlve; kryerja e veprimeve dhe prioriteti i veprimeve.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</b> zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri për krijimin e një programi në <i>Java</i> . <b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> <b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- familjarizohet me teknologjinë e <i>Java</i>-s;</li> <li>- krijon një program në <i>Java</i>;</li> </ul> njuh komandat për përpilimin dhe për ekzekutimin e programeve në <i>Java</i> . <ul style="list-style-type: none"> <li>- njuh variablat në <i>Java</i>;</li> <li>- evidenton rregullat e shkrimit të variabëlve;</li> <li>- kryen veprime midis variabëlve me lloje të dhënash të njëjta ose të përafërta.</li> </ul>		<b>Fjalë kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Java; JDK (Java Development Kit); Ecliper (Kepler).</li> <li>- Variabla.</li> </ul>	
<b>Burimet:</b> Libri mësimor; kompjuter; projektor digjital		<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Argëtim; gjuhë programimi.	

## Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve


### Organizimi i orës së mësimit

#### a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Metoda: Punë përgatitore

Për realizimit të kësaj teme pyes nxënësit nëse e kanë njohuri për programin *Java* dhe aplikacionet e tij. Nëpërmjet diskutimit, nxënësit thonë përvojat e tyre në lidhje me këtë program që “Shkruhet një herë dhe zbatohet kudo”.

Shkruan në tabelë emrin e programit *Java* dhe më pas vizaton skemën në tabelë. (E parapërgatit edhe në një fletë formati A4, të cilën nxënësit do ta plotësojnë në grupe dyshe).

Plotësimi i kësaj skeme do të bëhet me konceptet kryesore që nxënësit do të marrin gjatë këtij mësimi si dhe duke përdorur njohuritë e fituara nga përvojat jetësore.



**a. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Veprimtari e udhëhequr**

Duhet të kemi instaluar në kompjuter *JDK*-në dhe një *IDE*. Nëpërmjet diskutimit përmendin mënyrën si krijohet një kod në *Note Pad* dhe ruhet me prapashtesën *.java*. dhe të gjitha komandat që duhet të zbatojnë për krijimin e programit.

Ndjek mënyrën e krijimit të një programi në *Java* që do të bëjnë nxënësit. Kujtojnë se ku duhet krijuar kodi, përse duhet të shkruajnë të kutia dialogut *Run*, komandën *cmd*.

Demonstrohet njëkohësisht me nxënësit, rruga për ndërtuar një projekt në *Eclipse (Kepler)*.

**c. Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Metoda: Puno në dyshe**

Kontrolloj njohuritë 1, 2 fq. 82.

Shpjegoj termat më të rëndësishëm që lidhen me kodin *Java*:

```
public class ProgramiIm {  
    public static void main(String[] args) {  
        System.out.println(" Ju po mësoni  
gjuhen Java);  
    }  
}
```

**Organizimi i orës së mësimit(Ora e dytë)**

**a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme Metoda: Punë përgatitore**

Për të realizuar këtë orë mësimi ftoj nxënësit të lexojnë aktivitetet në fq. 83. Nëse do të paraqiteshin në një program kompjuterik, këto veti do të përbënin variabla për objektin student ose rreth. Përmendni veti të tjera që lidhen me këto objekte.

**b. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Veprimtari e udhëhequr**

Theksoj se që një variabël të jetë i përdorshëm në një program *Java* ajo duhet të deklarohet dhe të inicializohet p.sh.:

sintaksa e deklarimit: *int* mosha;

sintaksa i inicializimit: mosha=16;

deklarim dhe inicializim së bashku: *int* mosha=16.

Shpjegoj rregullat e shkrimit të variablave dhe thekson se pse është e rëndësishme që variablat të deklarohen përpara se të përdoren. Demonstrohet në projektor (Përgatit paraprakisht) ruajtja e vlerës së një variabli dhe ndryshimi i tij. Realizohen shembuj konkret për të kuptuar veprimet midis variablave dhe duke theksuar prioritet më të larta të disa veprimeve dhe prioritet në të ulët disa të tjerë.

**Vlerësimi:** Kjo orë do të quhet e realizuar nëse nxënësi:

- diskuton mbi përparësitë kryesore që e bëjnë *Java*-n një gjuhë programimi të suksesshme;
- ndërton një projekt në *Java*, duke përdorur *Eclipse* (*Kepler*) shkruan një kod të thjeshtë, e përpilon dhe e ruan atë.
- njih variablat, emërton variablat sipas rregullit të caktuar dhe kryen veprime me to.

Vlerësohet gjithashtu dhe puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve, duke marrë në konsideratë kontributin e secilit nxënësi.

**Detyrë shtëpie:** Ndërtoni një projekt në *Java*, duke përdorur *Eclipse(Kepler)* për të afishuar në ekran adresën e shtëpisë suaj.

## 6. Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësve është ndër komponentët më të rëndësishëm të kurrikulës me bazë kompetencat. Ky vlerësim, bazuar në rezultatet e të nxënësve, përfshin gjykimin për arritjet e nxënësve (njohuri, shkathtësi, qëndrime) përkundrejt niveleve të arritjeve.

Mësuesi, në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, siguron përdorimin e të gjitha llojeve të vlerësimit, të cilët përcaktohen si të domosdoshëm për të gjykuar në lidhje me arritjet e nxënësve, në funksion të mbështetjes së të nxënësve dhe mësimdhënies.

### Vlerësimi i nxënësit kryhet nëpërmjet:

- ☒ vlerësimit të vazhduar (vlerësimi për të nxënësi) (40%);
- ☒ vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse (vlerësimi i të nxënësve) (40%)
- ☒ vlerësimit të portofolit lëndor të nxënësit (20%).

Për vlerësimin e vazhduar të arritjes së rezultateve të të nxënësve, mësuesi **mban shënime në evidencë për çdo nxënësi**. Shënimet në evidencë mund të mbahen me **notë**, të shoqëruara me nivelin e arritjes dhe konceptin e temës mësimore (p.sh.: *N3: dallon pjesët kompjuterike*) dhe **simbole** të shoqëruara me komentimin përkatës. (p.sh.: +; √ : *aktivizim i rregullt; ose bashkëpunim; krijim në grup; dallimi i pjesëve të kompjuterit*).

- Për lehtësimin e punës së tij mësuesit i sugjerohet të shkruajë në fund të evidencës **një legjendë** e cila shpjegon kuptimin e simboleve të vendosura.
- Komentet i referohen **niveleve të arritjes së kompetencave lëndore** bazuar në dokumentin përkatës të “*Niveleve të arritjes*” shkalla 5 klasa 10-të..
- Mësuesi është i lirë të përshtatë **formatin e evidencës**, në varësi të specifikave të lëndës, ose të krijojë një formë tjetër të mbajtjes së shënimeve, duke ruajtur pjesën përmbajtësore të saj.
- **Evidenca** dorëzohet në drejtori në përfundim të periudhës dhe ruhet deri në përfundim të vitit shkollor.

Për të realizuar vlerësimin e vazhduar mësuesi i TIK-ut, ndihmon nxënësit të aftësohet sa më shumë në përdorimin e programeve kompjuterike. Kontrollon dhe korrigjon me takt gabimet që mund të bëjnë nxënësit gjatë përparimit për arritjen e dijeve. Vlerësimi duhet të jetë diagnostikues për të ndihmuar nxënësit në ecurinë e tyre dhe për ti motivuar për të tejkaluar gabimet.

Ndryshimi kryesor që ka ndodhur në vlerësimin e nxënësit gjatë zbatimit të kurrikulës së re është vlerësimi për të nxënë (vlerësimi i vazhduar). ***Fokusi kryesor i vlerësimit për të nxënë (vlerësimi të vazhduar) është që nxënësi të përmirësojë të nxënit e tij, si dhe të motivohet më shumë për të mësuar.*** Pra, vlerësimi për të nxënë nuk ka si qëllim kryesor vendosjen e një note, por të evidentojë te nxënësi pikat e forta dhe problematikat dhe ta ndihmojë që t’i përmirësojë ato. Në këto kushte, mësuesi duhet të fokusohet te procesi i të nxënit dhe jo te vendosja e notës.

#### **Si dokumentohet vlerësimi i vazhduar (vlerësimi për të nxënë)?**

- Fletorja personale dhe evidenca nënkuptojnë ***të njëjtin dokument***. Pra, mësuesi ka vetëm një dokument për vlerësimin e vazhduar (vlerësimin për të nxënë).
- Mësuesi mban shënime në fletoren e tij personale (apo në evidencë) ecurinë e progresit të nxënësit lidhur me rezultatet e arritjes.



- Fletoren personale (evidencën) mësuesi **e formaton në mënyrën më të përshtatshme për të**, por duke ruajtur logjikën e vlerësimit për të nxënë. Me fletoren personale (evidencën) mësuesi është i lehtësuar nga ngarkesa ose nga presioni për të vënë nota në regjistër në mënyrë të vazhduar.
- Mësuesi është i lirë t'i mbajë shënimet në fletoren e tij personale (evidencë) duke vendosur **simbolet, që ai gjykon si të përshtatshme**, të shoqëruara me komente shumë sintetike, të cilat iu referohen niveleve të arritjes së kompetencave lëndore.
- Komenti përmban nivelin e arritjes duke e shënuar me simbolin përkatës (**p.sh., N<sub>3</sub> ose N<sub>4</sub>**), si dhe **konceptin/konceptet përkatëse** për të cilin është vëzhguar nxënësi.
- Përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, punët individuale, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimi i nxënësit, vlerësimi i nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjet në aktivitete dhe diskutimet në klasë, detyrat e shtëpisë apo të klasës etj., **vlerësohen me simbole**. Vendosja e notës në mënyrë të vazhduar gjatë vlerësimit për të nxënë nuk ndihmon procesin e të nxënës, motivimin e nxënësve për të nxënë dhe zhvillimin e kompetencave.
- Nota në fletoren personale (evidencë) mund të vendoset **vetëm** në raste specifike, siç janë testet e ndërmjetme apo punët me shkrim etj.
- Nota e vlerësimit të vazhduar që vendoset në regjistër në faqen “Vlerësimi periodik” duhet të jetë **rezultante progresive (ose regresive) e vlerësimeve që mësuesi ka mbajtur** në fletoren e tij personale.
- Fletorja personale (evidenca) **është objekt monitorimi, por nuk** duhet dorëzuar në përfundim të periudhës.
- Mësuesi **mban përgjegjësi për fletoren personale** dhe duhet të argumentojë notën e vlerësimit të vazhduar të vendosur në regjistër.
- Mësuesi duhet **të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor** fletoren personale (evidencën), teste/detyra të ndërmjetme, punët me shkrim, etj.. Këto do t'i shërbejnë për të argumentuar notën e vlerësimit të vazhduar.
- Drejtuesit e shkollave nuk duhet të ngarkojnë mësuesit me detyrimin për të mbajtur dy dokumente për vlerësimin e vazhduar të nxënësve: evidencën e vlerësimit të vazhduar dhe fletoren personale të shënimeve, ato janë e njëjta gjë.
- Gjatë periudhës, mësuesi i lëndës ka përgjegjësi për të informuar nxënësin për ecurinë dhe mundësinë e tij për progres.

- **Model : Evidence për vlerësimin e vazhduar për 1 (një) periudhë (shtator-dhjetor):**

Emër Mbiemër Data	Shtator				Tetor				Nëntor				Dhjetor				Komenti
	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	
Tili Rexha			+														N3 Sintaksa
							√										N4 Shkrimi i kodeve
											10						
											-						N2 Variablat
															10		

Legjenda: (+; √): *aktivizim i rregullt; ose bashkëpunim; krijim në grup; respektimi i rregullave të kodimit, përdorim I saktë I kodeve*.

Legjenda: (-) *mosbashkëpunim në krijim; mos shkrimi I sakte I kodeve, vështirësi në implementim*

**Vlerësimi periodik**, bëhet në përfundim të çdo periudhe dhe përmban tri nota:

- *Vlerësimin e vazhdueshëm – NVv*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.
- *Vlerësimin me test ose detyrë përmbledhëse – NTP*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.
- *Vlerësimin e portofolit lëndor – NVp*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.

**Vlerësimi përfundimtar**, shënohet në regjistër duke plotësuar kolonat e “Vlerësimit Vjetor” dhe në kolonën e “Notës përfundimtare”.

**Vlerësimet vjetore përmbajnë:**

- *Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar* që është rezultat i tri periudhave.
- *Notën vjetore të vlerësimit me test ose detyrë përmbledhëse* që është rezultat i tri periudhave.
- *Notën vjetore të vlerësimit të dosjes së nxënësit* që është rezultat i tri periudhave.

Në rast kur ecuria e nxënësit është e dukshme progresive ose regresive gjatë dy periudhave të fundit, vlerësimi i tij vjetor në secilën nga rubrikat mund të jetë progresiv ose regresiv.

Nota përfundimtare llogaritet me përqindje për secilën nga rubrikat .

Pesha në përqindje e llojeve të vlerësimit është:

- *Vlerësimin e vazhdueshëm* – 40%
- *Vlerësimin me test ose detyrë përmbledhëse* – 40%
- *Vlerësimin e portofolit lëndor* – 20%

**Hapat për njehsimin e notës përfundimtare janë:**

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NV<sub>V</sub>), bazuar në tri notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Përcaktohet nota vjetore e testit/detyrës përmbledhëse (NT<sub>P</sub>) bazuar në tri notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NV<sub>P</sub>) bazuar në tri notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (psh.8,8 9).

**Formula:**  $(NV_V \times 0.4) + (NT_P \times 0.4) + (NV_P \times 0.2) = \text{Nota përfundimtare}$

**Përshkrimi i notës përfundimtare vjetore argumenton** nivelin e arritjeve të kompetencave të lëndës. Përshkrimi i referohet pikave më të forta që ka nxënësi lidhur me përbushjen e kompetencave të lëndës.

**Model. Nxjerrja e notës përfundimtare**

Periudha I			Periudha II			Periudha III			Notat vjetore			Nota përfundimtare
NV V	NT <sub>P</sub>	NV P	NV V	NT <sub>P</sub>	NV P	NV V	NT <sub>P</sub>	NV P	NV V	NT <sub>P</sub>	NV P	
7	8	9	9	8	10	9	9	10	9	8	10	9

$$(9 \times 0.4) + (8 \times 0.4) + (10 \times 0.2) = 8.8$$

## 7. Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse

Vlerësimi i të nxënimit ndryshe quhet vlerësim përmbledhës. Përdoret për të mbledhur prova dhe të dhëna që tregojnë nëse mësimdhënësia ka realizuar qëllimin e saj. Ky është një vlerësim formal dhe kryhet edhe për efekt raportimi.

### Si dhe kur realizohet testi/detyra përmbledhëse?

- Në pjesën e fundit të periudhës kryhet **vlerësimi me test ose me detyrë përmbledhëse**, që ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxënimit për periudhën përkatëse.
- Mësuesi ka lirinë të përcaktojë vetë nëse do të zhvillojë test apo detyrë përmbledhëse sipas specifikave të lëndës.
- Testi/detyra përmbledhëse planifikohet nga mësuesi. kur përmbyllet një grup rezultatesh të të nxënimit dhe mësuesi është ***i lirë ta vendosë vetë se kur do ta zhvillojë atë.***
  - Testi/detyra përmbledhëse është 45 minuta.
  - Drejtorja e shkollës menaxhon organizimin e testeve ose detyrave përmbledhëse sipas një grafiku, në mënyrë që të mos ngarkohet nxënësi në fund të periudhës.
  - Testi/detyra përmbledhëse ***jo domosdoshmërisht*** bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e përcakton vetë kohën se kur do ta zhvillojë atë.
  - Në momentin kur mësuesi ***vlerëson testet/detyrat përmbledhëse, i vendos*** notat në regjistër.
  - Mësuesi duhet ***të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor*** testet ose detyrat përmbledhëse.

Është një vlerësim që për lëndën e TIK-ut duhet të zhvillohet më shumë nëpërmjet testeve praktike, realizimi i njohurive të marra në praktikë. Testi ose detyra përmbledhëse, ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxënimit.

- Mësuesi përzgjedh të zhvillojë test ose detyrë përmbledhëse, në varësi të veçorive të lëndës.
- Testi ose detyra përmbledhëse përmban vetëm rezultatet e të nxënimit (njohuritë dhe shkathtësitë) kryesore të periudhës përkatëse.

- Koha e realizimit të testit ose detyrës përmbledhëse është 45 min. si të gjitha testet e tjera.

Mësuesi zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të vlerësohet nëpërmjet një larmi mënyrash vlerësimi:

- Konkurs nëpërmjet punëve reale që zhvillon çdo nxënës duke përdorur programet kompjuterike.
- Me test me shkrim për njohuritë/ aftësitë e arritura gjatë tre-mujorit.

Testet lejojnë shumëllojshmëri mënyrash të demonstrimit të aftësive të nxënësve. Prandaj:

- ✘ nxënësit duhet të kuptojnë qëllimin dhe vlerën e testit;
- ✘ testi duhet të masë arritjen e rezultateve të të nxënit për një periudhë të caktuar;
- ✘ duhen dhënë udhëzime të qarta për secilën pjesë të testit;
- ✘ pikët duhet të jepen për çdo pyetje apo rubrikë të testit;
- ✘ pyetjet duhet të jenë të llojeve të ndryshme (po/jo, e saktë/e gabuar, me zgjedhje të shumëfishtë, çiftim i elementeve, plotësim i vendeve bosh, zëvendësim i elementeve);
- ✘ testi duhet të masë aftësinë problem zgjidhëse që kanë fituar nxënësit gjatë arritjes së njohurive;

***Testet duhet:***

- ❖ të jenë të lehtë për t'u lexuar dhe të ketë hapësirë ndërmjet pyetjeve për të lehtësuar leximin dhe shkrimin;
- ❖ të përfshijnë një sërë rezultatesh të nxëni;
- ❖ të mund të kryhen nga nxënësit me nevoja të veçanta;
- ❖ i krijojnë mundësi nxënësve të zgjedhin kërkesat e ushtrimeve në mënyrë të pavarur nga njëra – tjetra;
- ❖ të kenë nivele të ndryshme të pyetjeve për të përfshirë aftësitë problem zgjidhëse, mendimin kritik dhe atë krijues;
- ❖ të llogariten me kohë të mjaftueshme për të përfunduar të gjithë nxënësit;

Gjatë ndërtimit të testeve të arritjes mësuesi duhet të ketë në konsideratë:

- ❖ Numri i pyetjeve në teste varet nga rezultatet e të nxënit që mësuesi do të masë.

- ❖ Është mirë që testet të hartohen me pyetje të llojeve të ndryshme; në lëndën e TIK-ut nuk rekomandohet përdorimi i pyetjeve të hapura, por i pyetjeve të strukturuar, me alternativa, i pyetjeve me zgjidhje të shkurtër, dhe mbi të gjitha pyetje që kërkojnë zbatimin praktik të njohurive.
- ❖ Kur bëhen pyetjet mësuesi duhet të llogarisë, që nxënësi ka në dispozicion 45 minuta. Kohë brenda së cilës ai duhet të ketë hapësirën e duhur për të lexuar pyetjen dhe për t'ju përgjigjur asaj.
- ❖ Mësuesi duhet të sigurohet që kërkesat të kuptohen qartë nga të gjithë nxënësit. Këshillohet që pyetjet dhe kërkesat e tekstit të jenë të artikuluar sa më qartë.
- ❖ Mësuesi duhet të sigurohet që në test ka përfshirë të gjitha njohuritë që ai konsideron të rëndësishëm për periudhën në të cilin realizon testin.

### 7.1 Hartimi i testit

Hartimi i një testi kërkon përkushtim të plotë nga ana e mësuesit. Mësuesi duhet të përcaktojë qartë qëllimin e testit të saj. Duhet të shënoj cila janë rezultatet për të cilat ajo do të testojë nxënësit. Për këtë arsye ai duhet të përcaktojë:

- 1) **Listën e njohurive që ai do të vlerësojë.**
- 2) Përcaktimi i peshës së niveleve që do të zbatohet në test. **Niveli i dytë** i arritjes së kompetencave (rekomandohet 40%) përfshin pyetje ku kërkohet që nxënësi të zbatojë zgjidhjet e ushtrimeve që ka realizuar në klasë. **Niveli i tretë** i arritjes së kompetencave (rekomandohet 40%) përfshin pyetje ku nxënësit duhet ti japë zgjidhje problemit, duke ripërdorur njohuritë e përfituara. **Niveli i katërt** i arritjes së kompetencave (rekomandohet 20%) përfshin pyetje që zhvillojnë aftësitë krijuese, kritike dhe problem zgjidhëse të nxënësve, duke u bazuar tek njohuritë e përfituara.
- 3) **Ndërtimi** i tabelës duke u bazuar tek tematikat dhe rezultatet e të nxënit që mësuesi ka realizuar në një periudhë. P.sh. në periudhën e parë

<b>Tematikat</b>	<b>Përqindja = Pikët</b>	<b>Rezultatet e të nxënit</b>	<b>Niveli II i arritjes së kompetencave</b>	<b>Niveli III i arritjes së kompetencave</b>	<b>Niveli IV i arritjes së kompetencave</b>
Bota kompjuterit.	10 (orë)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• janë të vetëdijshëm për parimet ergonomike;</li> <li>• njohin tipet e rrjeteve dhe topologjinë e tyre;</li> </ul>	.....	.....	.....
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• njohin komponentët e rrjetit;</li> <li>• vlerësojnë tipet e ndryshme të kanaleve të transmetimit;</li> </ul>			
Përpunimi digjital	12 (orë)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• përdorin organizues grafik dhe storyboard për planifikim;</li> <li>• njihen me programin FLASH;</li> <li>• krijojnë dhe integrojnë skenarë në FLASH;</li> <li>• përdorin Macromedia FLASH për krijimin e animacioneve;</li> </ul>			
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• shtojnë një File në Dok HTML;</li> </ul>			
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• përpunojnë të dhëna (përdorin mjetet e FLASH për të krijuar dhe modifikuar vizatimet artistike në skenarë);</li> </ul>			
<b>Pikët total të testit</b>	<b>100% = ... pikë</b>		<b>30 - 40%= ... pikë</b>	<b>40%- 45% = ... pikë</b>	<b>20% - 25% = ... pikë</b>

### Hartimi i pyetjeve të testit.

4) Përcaktimi i skemës së vlerësimit (bazuar në shpërndarjen normale). Sistemi i pikëzimit që përdoret më shumë është ai që quhet analitik. Dy nga elementet bazë të këtij sistemi janë:

- caktimi i pikëve për tematikat që do të realizohet testi;
- skema e pikëzimit (ku jepen kriteret e shpërndarjes së pikëve që janë akorduar për tematikat që do të testohen, duke pasur parasysh për bazë përgjigjen e saktë që duhet të jepet për këtë çështje).

Në konvertimin e pikëve me nota, kufiri i poshtëm rekomandohet 25% e totalit të pikëve. Më pas caktohen intervalet e pikëve nga nota 4 – 10.

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Përqindja e pikëve	<25%	2 38%	39- 51%	52- 64%	65-77%	78-90%	91-100%

### 7.2 Llojet e pyetjeve që hartohen në teste

Llojet e pyetjeve që mund të përdoren në teste mund të paraqiten si më poshtë:

a) Pyetje me alternativa (me zgjedhje të shumëfishtë).

- Një pyetje me zgjedhje të shumëfishtë përbëhet nga dy pjesë: nga trangu dhe përgjigjet alternative ndër të cilat dallohet përgjigja e vetme e saktë.
  - Alternativat duhet të vendosen vertikalisht pas përmbajtjes së pyetjes, në përputhje me rendin alfabetik.
  - Nuk duhet të përdoren alternativa që përplasen me njëra - tjetrën.
  - Pyetjet ndërtohen në përgjithësi me 4 alternativa.
  - Alternativat duhet të kenë gjatësi të njëjtë.
  - Alternativat duhet të jenë homogjene dhe t'i referohen të njëjtës kategori.



- Në alternativa nuk duhet të ketë mbivendosje të dhënash apo intervalesh kohore.
  - Vetëm një alternativë është e saktë.
  - Pyetja me alternativë vlerësohet me një pikë.
  - Në përgjithësi rekomandohet të mos përdoren si alternativa shprehjet “asnjë nga të mësipërmet”, ose “të gjitha të mësipërmet”.
  - Pyetjet me alternativa shmangin në shkallë të lartë subjektivitetin në pikëzim.
- a) Pyetjet “Po/Jo” ose “e vërtetë/ e gabuar”**
- Përgjigja e saktë për këto lloj pyetjesh vlerësohet me një pikë.
- b) Pyetjet me çiftim**
- Për çdo çiftim të saktë jepet një pikë, pra nëse ushtrimi ka 4 kombinime nga të dy kolonat, ai do të marrë 4 pikë, nga 1 për çdo kombinim të saktë.
- c) Pyetjet me plotësim**
- Për çdo plotësim të saktë jepet një pikë.
- d) Pyetjet me zgjidhje të shkurtër**
- Formulimi i tyre kërkon një përgjigje të përcaktuar e të përpiktë.
  - Këto pyetje kërkojnë nga 1 deri në 5 minuta kohë për t’u lexuar e për t’u përgjigjur.
  - Këtu hyjnë pyetje në të cilat nxënësit i kërkohet të bëjnë një figurë, të kryejë një njehsim, të paraqesë shkurt një argumentim, të zgjidhë një ushtrim etj..
  - Këto lloj pyetje kërkojnë më shumë se një miratim të thjeshtë a një kujtesë mekanike.
  - Ka më pak mundësi që nxënësit ta gjejnë përgjigjen me hamendje në krahasim me pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë.
- e) Pyetje të strukturuar**
- Strukturimi i një pyetjeje (situate) është zbërthimi i saj në elemente përbërës me karakteristikat kryesore që meritojnë të studiohen.

- Shkalla me të cilën mësuesit do të zërthejnë një pyetje (ose situatë) varet nga natyra dhe kompleksiteti i saj, nga niveli i të mësuarit dhe aftësitë individuale të nxënësve.
- Kur pyetja (situata) është shumë komplekse dhe aftësitë nuk janë të larta duhet të rritet shkalla e strukturimit.
- Një nga funksionet e pyetjeve të strukturuar është që ta mundësojnë lidhjen midis mësimdhënies, të nxënësve dhe vlerësimit të arritjes.
- Në një pyetje të strukturuar nxënësit i kërkohet të njihet me informacionin që jepet në trungun e përbashkët të pyetjes dhe më pas t'i përgjigjet një sërë kërkesash që lidhen me përmbajtjen e këtij trangu dhe që testojnë në mënyrë progresive njohuritë e nxënësit rreth çështjes.
- Si rregull niveli i vështirësisë së këtyre pyetjeve vjen duke u rritur.
- Pyetjet duhet të jenë të pavarura nga njëra tjetra dhe përgjigjja e saktë për një pyetje nuk duhet të varet nga përgjigjja e saktë e pyetjes paraardhëse.
- Kur kjo nuk është e mundur të realizohet ( p.sh. në pyetjet e strukturuar që kërkojnë llogaritje), atëherë gabimi që rrjedh prej përgjigjes së gabuar në pyetjen e mëparshme nuk duhet të merret në konsideratë në pikëzimin e përgjithshëm.

**f) Pyetje të hapura**

Këto lloj pyetjesh mund të kenë disa përgjigje të sugjeruara nga nxënësit. Në këtë rast vlerësohen argumentet që jep nxënësi dhe saktësia në arsyetimin e mendimeve dhe veprimeve përkatëse.

## MODEL TESTESH

### TEST fund periudhe

**Koha e nevojshme për realizimin e testit: 45 minuta**

**Emër Mbiemër** \_\_\_\_\_

**Klasa:10**

**TEZA 1**

1-E vërtetë apo e gabuar (1 pikë për çdo pyetje)

- |  |   |   |
|--|---|---|
| • Një gigabyte është më e vogël se një megabyte                    | V | G |
| • Një kilobyte është 1028 byte                                     | V | G |
| • Njësia e ruajtjes së informacionit është Hertz-i                 | V | G |
| • Një software sistemi kryen detyra që lidhen me sistemin operativ | V | G |
| • Ms-Office është një grup software aplikacionesh                  | V | G |

5pikë

3-Software të sistemit janë ato që \_\_\_\_\_ punën e kompjuterit duke luajtur rolin e ndërfaqes makinë-njeri. **2 pikë**

4-Tregoni disa nga parimet ergonomike që duhet të zbatoni gjatë punës në kompjuter. 4 pikë

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_
- d) \_\_\_\_\_

5-Për të bërë backup-in e programeve, konfigurimeve të sistemit dhe të skedarëve ndjekim hapat:

**5 pikë**

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_

d) \_\_\_\_\_

e) \_\_\_\_\_

**6-Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e tre llojeve të Mind mapping-ut?**

**4 pikë**

- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

**7- Jepni ndryshimin ndërmjet një harte konceptuale të gatshme në MindView dhe një harte konceptuale bosh. 4 pikë**

## 8-Interpreto elementet e figurës:



**6 pikë**

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Piket	0-7	8-11	12-15	16-21	22-25	26-28	29-30

## 8. Projekti kurrikular

- Projekti kurrikular në lëndën TIK-ut është rubrikë e detyruar e portofolit të të nxënës.
- Projekti kurrikular është strategji e të nxënës dhe mësimdhënies me në qendër nxënës nëpërmjet të cilës nxënës në mënyrë të pavarur ose/dhe si një anëtar i një grupi hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale. Projekti si veprimtari integruar me karakter kërkimor e krijues nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK, të sipërmarrjes etj..
- Zbatimi i një projekti në lëndën e TIK-ut kërkon më shumë se një orë mësimore, të cilën nxënës e realizon jashtë procesit mësimor. Mësuesi mund të parashikojë nga një orë në dispozicion në klasë ku nxënës mund të bëjnë prezantimin ose të krijojnë grupet e punës.
- Projekti kurrikular mund të jetë i shtrirë përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tri periudhat, por mund të jetë i shtrirë edhe vetëm brenda një periudhe. Sido që të jetë shtrirja e projektit, ai e ka vlerësimin e tij brenda vlerësimit të portofolit. Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në mendje instrumentin për vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënës dhe përgjatë zhvillimit të tij. Nëse projekti ka shtrirje përgjatë gjithë vitit, në çdo periudhë vlerësohet si pjesë e portofolit ajo pjesë e projektit që është realizuar. Në rastin kur ka shtrirje brenda një periudhe vlerësohet i gjithë projekti.
- Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efektive i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënës (është mjaft e rëndësishme që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënës që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënës për arritjen përfundimtare të projektit; të qartësojë nxënës për kriteret e vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.
- Për realizimin e projektit shfrytëzohen përvojat vetjake të nxënësve dhe njohuritë e marra nga burime të ndryshme.

- Realizimi i një projekti në lëndën e TIK-ut kërkon përdorimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: kërkime, grumbullim të dhënash, intervista, puna në grup, puna individuale etj.
- Statet kryesore që ndiqen për realizimin e një projekti janë:
  - \* Përcaktimi saktë i çështjes ose problemit për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.
  - \* Përcaktimi qartë i detyrave që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënës.
  - \* Grumbullimi i materialit dhe/ose mjeteve të nevojshme.
  - \* Përpunimi, analizimi dhe redaktimi i të dhënave të grumbulluara.
  - \* Nxjerrja e përfundimeve nga të dhënat e grumbulluara.
  - \* Përgatitja e produktit përfundimtar.
  - \* Prezantimi i projektit ose i produktit të krijuar.
- Për planifikimin e një projekti mësuesi ndërton planin e projektit, rubrikat kryesore të të cilit paraqiten më poshtë. Në varësi të tematikës së projektit dhe specifikave të tij mësuesi mund të pasurojë planin me rubrika të tjera. Mësuesi planifikon në planin e tij ditore çdo orë të planifikuar të projektit sikurse vepron me orët e tjera mësimore.

Rubrikat kryesore të planit të një projekti kurrikular përfshijnë:

- **Tema e projektit** (përcaktohet nga mësuesi në bashkëpunim me nxënësit)
- **Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore** (nëse projekti është ndërlëndor, përcaktohet kontributi i çdo mësuesi dhe orët mësimore për secilën lëndë).
- **Klasa/t pjesëmarrëse** (përcaktohet klasa ose në rast se ka disa klasa).
- **Rezultatet e të nxënit** (përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që do të zhvillohen përmes veprimtarive të projektit.)
- **Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:** (përcaktohen konceptet që duhet të zotërojë nxënësi për realizimin e këtij projekti).
- **Partnerët** (mund të jenë prindërit, mësuesit e lëndëve të tjera, ose aktorë që punojnë në fushën e TIK-ut).

- **Veprimtaritë kryesore që do të kryen për realizimin e projektit, afatet dhe personat përgjegjës.**
- **Burimet kryesore të informacionit** (mësuesi duhet të orientojë nxënësit drejt përdorimit të burimeve të larmishme dhe të duhura të informacionit. Në lëndën e TIK-ut burim është informacioni i marrë nga interneti (youtube, bibliotekat apo cd dhe dvd të ndryshme).
- **Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor** (këtu vendoset tematika për çdo orë mësimore të projektit. P.sh. nëse projekti planifikohet në 3 orë atëherë duhet vendosur tematika për të tri orët)
- **Përshkrimi i produktit të projektit** (duhet të përfshijë shkurtimisht llojin e produktit që pritet të realizohet dhe mënyrën e prezantimit të tij).
- **Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi** (mësuesi përcakton kritere për vlerësimin e projektit të cilat ia komunikon nxënësit që në fillim të projektit. P.sh., kriteret mund të përcaktohen në lidhje me trajtimin e përmbajtjes në përmbushje të tematikës, përdorimin e burimeve të informacionit, përgatitjen e produktit, prezantimin e tij etj., në varësi të rezultateve të të nxënësve).

**Shembuj kriteresh për vlerësimin e projektit:**

• A është fokusuar përmbajtja e projektit te çështja/problemi i identifikuar për shqyrtim?
• A është lidhur tema e projektit me situata nga jeta reale?
• A i kanë zbatuar nxënësit konceptet e marra në lëndën përkatëse?
• A kanë mbledhur të dhëna bazuar në burime të mjaftueshme informacioni?
• A kanë bashkëpunuar nxënësit për të zhvilluar aftësitë komunikuese, vetëmenaxhuese dhe organizuese?



Sigurimi i të dhënave nga burime të ndryshme vlerësimi është thelbësore për të nxënin bazuar në projekte. Përfshirja e nxënësve në vlerësimin e projektit nxit motivimin dhe përmirëson të nxënit e drejtuar prej tyre. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri, nxit nxënësit të reflektojnë mbi pikat e tyre të dobëta dhe të forta, në mënyrë që të fokusojnë përpjekjet e tyre të mëtejshme.

***Hapat e një projekti kurrikular*** me shtrirje përgjatë 6 muajve.

## **Realizimi i një projekti kurrikular nëpërmjet metodës së Projektit kërkimor**

### **Faza 1. Parapërgatitja për projektin : Tema : Përdorimi i sigurt i internetit: Cyberbulling**

- ☞ Paraqitet projekti që do të ndërmerret: Do të realizohen aktivitete që do të ndikojnë në sigurinë kibernetike si dhe prezantime dhe punime për ditën e Internetit të Sigurt.
- ☞ Caktohet koha gjatë së cilës do të realizohet projekti: Projekti do të realizohet nga shtatori- mars. Nxënësi do të marrë vlerësim për secilën periudhë.
- ☞ Kërkohet formulimi i saktë i objektivave që do të arrihen nga nxënësit. Objektivat në këtë fazë janë tepër ambicioze. Ato prekin jo vetëm objektivat në nivelin e njohurive, por në nivelin e analizës, të sintezës, të zbatimit, të vlerësimit. Objektivat e formuluarat dhe detyrat mësimore që do të arrihen në fund të projektit, duhen t'u bëhen të qarta nxënësve që në fillim dhe të sigurohemi për qartësinë e detyrës.
  - Krijimi i video-tutorialeve duke përdorur programin Adobe-Flash.
  - Realizimi i posterave duke përdorur Adobe-Flash.
  - Realizimi i 30 intervistave me fëmijët e moshave nga 16-18 vjeç, se çdo të thotë për ta Cyberbulling.
- ☞ Kërkohet që nxënësi të përcaktojë partnerët që do të bashkëpunojë në këtë projekt kërkimor. Ata mund të jenë: mësues, nxënës të klasave paralele, prindër, përfaqësues të bashkësisë etj. Atyre duhet t'u bëhet e qartë detyra mësimore që do të realizohet bashkërisht, si dhe kur do të realizohet përfshirja e tyre.
  - Nxënësit mund të bashkëpunojnë me nxënësit më të rritur, për të realizuar intervistat.

- Mund të kërkohet ndihma e prindërve për incizimin e intervistave, të kërkohet informacion online se sa të cënuar ndihen bashkëmoshatarët e tyre nga Cyberbulling.
- Mund të bashkëpunohet me televizione për të bërë një emision të shkurtër.
- ☞ Përcaktohen teknikat dhe mjetet që do të përdoren në funksion të projektit.
  - Kasetofon për incizimin e intervistave.
  - Internet, dhe kompjuter për realizimin e posterave dhe gjetjen e informacionit.
  - Fleta me ngjyra ose artikuj revistat që japin info rreth temës.
- ☞ Paracaktohen produktet e projektit.
  - workshop ditën e Internetit të Sigurt.
  - 3 Video-Tutoriale.
  - Analizë grafike e dalë nga intervistat.

## **Faza 2.** Puna rreth projektit

- ☞ Grupet e nxënësve zbatojnë detyrat e përcaktuara nga mësuesi për të realizuar dhe përfunduar detyrën mësimore.
- ☞ Formulohen pyetësorët e përgatitur qëllimisht për të grumbulluar informacionin e kërkuar në funksion të detyrës mësimore (pyetësorët mund të përgatiten nga mësuesja në ciklin e ulët ose nga nxënësit në shkollën e mesme).
- ☞ Plotësohen pyetësorët dhe përmbledhen të dhënat.
- ☞ Zhvillohen intervistat e caktuara paraprakisht dhe dokumentohen ato në kasetofon nëse ka mundësi.
- ☞ Fiksohen vrojtimitet e bëra nga nxënësit. Ato mund të jenë cikël fotografish të bëra nga nxënësit ku fiksohen pamje të cilat sjellin informacion rreth projektit, shënime të mbajtura nga nxënësit, ku të jetë e pranishme data, vendi, problemi.
- ☞ Grumbullohen materialet e siguruar nga intervistat, pyetësorët vrojtimitet dhe nxirren përfundimet.
- ☞ Sistemohen të dhënat dhe fillon faza e përgatitjes për ta bërë të njohur përfundimin e projektit kërkimor në prani të një publiku në shkallë më të gjerë.

### **Faza 3. Vlerësimi.**

Bëhet vlerësimi i punës ku përmbledhen pikat kryesore, renditen faktet e paraqitura, tregohet se çfarë është e realizuar, si është bashkëpunuar me partnerët dhe kush janë përfitimet apo produktet apo gjetjet në këtë projekt. Duhet që secili nga nxënësit të marrë vlerësimin sipas angazhimit që ai ka bërë për realizimin e projektit, dhe mësuesi të ketë ndarë paraprakisht të gjitha detyrat që duhet të realizojë secili nga nxënësit.

Mësuesit në periudhën e parë, vlerëson se sa nxënësit ka përdorur saktë komandat e Adobe-Flash për të realizuar videot. Vlerëson dhe saktësinë e realizimit të intervistave si dhe përpunimin e të dhënave nëpërmjet programeve multimediale p.sh. MindView, për të analizuar dhe prezantuar të dhënat në mënyrë grafike.

Në periudhën e dytë, do të vlerësojë përfshirjen e nxënësve për të prezantuar punimet, saktësinë për të folur para një audience të caktuar, si dhe qartësinë e informacionit të përzgjedhur.

### **IX. Portofoli në lëndën e TIK-ut.**

Kur nxënësit arrijnë të vetëvlerësojnë punën dhe të nxënëit e tyre, themi se kemi arritur të realizojmë një mësimdhënie efektive. Duke kthyer kokën mbrapa në proceset që janë kryer, duke analizuar me kujdes atë që ka ndodhur, nxënësit fitojnë kuptime dhe ide të reja rreth vetes së tyre si persona që nxënë. Duke e parë punën e tyre në raport me të tjerët, ata do të mësojnë si të përmirësojnë më tepër punën e tyre, si të fitojnë njohuri, shprehi dhe shkathtësi të reja.

**Vetëvlerësimi dhe vetëreflektimi nuk kryhen në fund të kapitullit, të gruptemave apo pas marrjes së disa notave. Ato janë procese që ndodhin në mënyrë të vazhdueshme. Siç theksojnë Zessoules & Gardner (1991) nxënësit duhen mësuar si t'i fitojnë dhe t'i zhvillojnë “aftësitë reflektuese të mendjes”.**

Prandaj, mbajtja e portofolit është mënyra më e mirë për ta bërë këtë.

Mënyrat tradicionale të dhënies së listës të notave, të marra brenda një muaji, dëftesat dhe notat e fundit të vitit shkollor etj., priren të zbulojnë se nxënësi ka dobësi, por jo se ku i ka konkretisht dhe cilat janë shkaqet e tyre.

Punimet dhe detyrat e futura në portofol janë mjete të fuqishme që i ndihmojnë nxënësit të zbulojnë anët e forta, dobësitë, mangësitë, vështirësitë dhe problemet që hasin gjatë procesit të punës, si dhe ofrojnë larmi mundësish për t'u përmirësuar. Ato dëshmojnë përparimin e nxënësve, aftësitë dhe mundësitë, si dhe nivelin e arritur.

Mbajtja e portofolit personal dhe grumbullimi i materialeve është një mundësi e mirë edhe për prindërit për të njohur realisht se cili është fëmija e tyre, si nxë, sa dhe deri ku është në gjendje të përparojë, të dinë se deri ku mund t'u kërkojnë fëmijëve të tyre, ku duhet të punojnë e t'i ndihmojnë më tej. Ky proces nis që në fillim të vitit shkollor, kur vendosen punimet e nxënësve, shënimet dhe vlerësimet e mësuesit dhe komentet e prindërve.

Portofoli i nxënësit nuk është thjesht një koleksion ose mbledhjesh punimesh të rastësishme, por është një koleksion i qëllimshëm i punës së nxënësve, që tregon përpjekjet, arritjet, përparimin në një ose disa fusha apo lëndë. Zhvillimi dhe formimi i tyre nuk shfaqet vetëm në produktet përfundimtare. Ai është proces në vazhdim, që pasurohet çdo ditë.

Analiza dhe vlerësimi i punimeve të futura në portofol shërbejnë si nyje ndërmjet procesit të mësimdhënies, të nxënësve dhe reflektimit të mësuesit dhe nxënësve.

Rishikimi i dosjes së detyrave dhe punimeve bëhet në periudha afatshkurtra, kurse vlerësimi i saj bëhet në periudha më afatgjata, si p.sh.: në fund të çdo periudhe, në fund të vitit shkollor, në fund të shkallës së kurrikulës ose në fund të një cikli shkollimi.

Vlerësimi përshkruar bazohet në analizën e plotë dhe të kujdesshme të punimeve me shkrim që janë futur në dosjen e nxënësit si dhe në pjesëmarrjen e tij në veprimtari të ndryshme që zhvillohen në shkollë.

## Fazat e krijimit të portofolit të nxënësit

### 1. Vendosja e kritereve

Para se të nisë ky proces duhen hartuar dhe vendosur cilat do të jenë kriteret e krijimit dhe të vlerësimit të dosjeve. Këto kriteret duhen diskutuar me nxënësit dhe prindërit, në mënyrë që të dihet nga secila palë se cilat janë qëllimet, formati dhe përmbajtja e dosjeve, çfarë pritet dhe ku duhet të përqendrohet puna e përbashkët në të ardhmen. Kur këto kriteret do të diskutohen me prindërit sugjerohet që mësuesi të mbajë parasysh çështjet e mëposhtme:

- *Çfarë pret nga puna e nxënësve dhe ndihma e prindërve;*
- *Cilat janë synimet e tij për punimet e materialet që mbledh nga nxënësit;*
- *Cilat mund të jenë vështirësitë për mësuesin dhe për prindërit;*
- *Sa ndikon përditësimi i punimeve të portofolit në përparimin e fëmijës etj..*

### 2. Organizimi i përmbajtjes së portofolit

#### a) *Struktura e portofolit:*

Në portofol futen:

- detyra që kanë lidhje me konceptet kryesore të trajtuara gjatë secilës periudhë;
- punime individuale që kanë rendësi për zhvillimin e njohurive të nxënësit;
- punime tematike;
- projekte kurrikulare;
- fisha vetëvlerësimi;
- opinione dhe mendime të nxënësve për punët e përbashkëta në grup;
- teste, që dëshmojnë përparimin e nxënësit në periudhat të ndryshme të vitit shkollor.

***Për një periudhë, portofoli duhet të përmbajë dy- tre detyra duke përfshirë projektin kurrikular.***

📁 Projekti ose një fazë e tij është pjesë e detyruar e portofolit për çdo periudhë.

📁 1 -2 detyra krijuese, zbatuese, hulumtuese etj.

Detyrat e portofolit mund të jenë punime të kryera në klasë dhe/ose jashtë saj, dëshmi e kontributeve dhe talentit të nxënësit, me karakter hulumtues dhe krijues të tilla si:

- *Krijime* të ndryshme artistike që nxënësi i realizon nëpërmjet programeve kompjuterike, siç mund të jenë posterat, ose ftesa për evente që nxënësi mund ti krijojë me programin paint ose word.
- *Regjistrime* të ndryshme në kasete dhe fotografi të bëra në mjedise e procese të ndryshme pune, në kohën e lirë, në zhvillimin e një veprimtarie jashtëshkollore, në ekskursionet etj. P.sh detyrat që realizon nëpërmjet projektit kërkimor. **Mund të jetë krijimi i një posteri për Cyberbulling.**
- *Punë me kompjuter*, të cilat demonstrojnë aftësitë dhe shkathtësitë e nxënësit në kompjuter. Mund të jenë shkrime, vizatime, shfrytëzimi i programeve të ndryshme të kompjuterit etj..
- *Shkrime* të natyrave të ndryshme, për tema të dhëna ose të lira, të zhvilluara në shkollë, në shtëpi, përshtypje, mbresa, kujtime etj.
- *Zgjidhje të ushtrimeve dhe problemeve* të vështira, të cilat nxënësi i ka marrë nga teksti i nxënësit, nga libra të tjerë jashtëshkollorë ose mund të jenë mënyra të tjera që ka përdorur për t'i zgjidhur.

**Kujdes! Detyrat që nxënësi i ka realizuar në kompjuter, të cilat mund të jenë dokumente në PDF, ose Excel, nxënësi nuk ka pse ti printojë mjafton që t'ia dorëzojë mësuesit në CD ose ti dërgoj në e-mail, dhe mësuesi të mbajë shënimin, në lidhje me vlerësimin që i ka vendosur nxënësit për këtë detyrë.**

Pra, siç duket edhe nga rubrikat e mësipërme, punimet që futen në portofol janë të larmishme dhe i japin mundësi çdo nxënësi të shfaqë dhe të tregojë çfarë di dhe çfarë është në gjendje të bëjë.

**Lind pyetja: Si mund ta bëjmë procesin e krijimit të portofolit sa më natyral dhe të këndshëm edhe për nxënësit? Kushtet që duhen plotësuar janë:**

- T'u krijohet mundësi nxënësve për të reflektuar për punën e bërë;

- Krijimi i mundësive për të bërë reflektime dhe vetëvlerësime: modele, formate e shembuj të vetëvlerësimeve, dhënia e herë pas hershme e dosjeve për t'u kontrolluar, përmirësuar e pasuruar etj.;

***Përfitimet nga mbajtja e dosjeve personale dhe dokumentimi i përparimit të secilit nxënës dhe i sjelljes së tyre janë të shumta.***

- *Për mësuesin*, përmbajtja e portofolëve tregon thellësinë, gjerësinë dhe shkallën e të kuptuarit të njohurive të nxënësve. Brenda secilës dosje gjenden pjesë e histori të ndryshme të nxëni. Mësuesi njih cilat janë prirjet, interesat, anët e forta, dobësitë, mangësitë dhe nevojat e nxënësve.
- *Për nxënësin*, japin një panoramë të përgjithshme të punës së tyre. Punimet e tyre pasqyrojnë përkushtimin e nxënësve, përpjekjet e bëra, rezultatet e arritura, vështirësitë që i kanë dalë, kontributin në punën në grup, arritjet e tij. Detyrat e kryera u japin mundësi nxënësve të reflektojnë në punën e bërë dhe të përmirësohen në periudhën në vazhdim. Nxënësit fitojnë edhe aftësi estetike për rregullimin dhe sistemimin e materialeve, ndërgjegjësohen për përparimin e tyre, njohin më mirë veten e tyre edhe në aspekte ndoshta të pazbuluara më parë.

***b) Vlerësimi i portofolit***

***Për një periudhë, detyrat që vlerësohen në portofol janë:***

📁 Projektin ose një fazë e tij, e cila është pjesë e detyruar e portofolit për çdo periudhë.

📁 1 -2 detyra krijuese, zbatuese, hulumtuese etj.

*(P.sh., në lëndët me 1-2 orë në javë portofoli mund të përmbajë një detyrë hulumtuese dhe një fazë të projektit lëndor ose gjithë projektin, ndërsa lëndët me më shumë se 2 orë, portofoli mund të përmbajë 2 detyra hulumtuese dhe një fazë të projektit lëndor ose gjithë projektin, nëse është projekt i vogël).* Detyrat e portofolit duhet të jenë me të njëjtën temë për çdo nxënës. Detyrat e portofolit mund të jenë punime të kryera në klasë dhe/ose jashtë saj, dëshmi e kontributeve dhe talentit të nxënësit, me karakter hulumtues dhe krijues të tilla si:

- punë praktike individuale,
- produkte të krijuara nga nxënësit,
- punime audio-vizuale,

- aktivitete në grup ose individuale;
- projekte individuale ose në grup;
- etj.

*Kujdes! Detyrat NUK duhet të jenë domosdoshmërisht të punuara me kompjuter.*

### **Si dokumentohet dhe vlerësohet portofoli?**

- Në fillim të periudhës, mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, përcaktojnë detyrat që do të përfshijnë në portofol përgjatë periudhës, në varësi të specifikave të lëndës.
- Mësuesi përcakton kriteret e vlerësimit të portofolit.
- Mësuesi në fillim të periudhës përcakton dhe iu prezanton nxënësve peshat/pikët për vlerësimin e secilës detyrë të portofolit dhe kriteret e vlerësimit të tij.
- Vlerësimi i secilës detyrë të portofolit bëhet mbi bazë të kriterëve që mësuesi vendos, duke u bazuar në llojin e detyrës së dhënë.
- Mësuesi ka përgjegjësi për vlerësimin e portofolit bazuar në kritere vlerësimi duke argumentuar notën e tij.
- Instrumentet që mësuesi harton për kriteret e vlerësimit të portofolit ***nuk janë objekt monitorimi.***
- Detyrat e portofolit apo një fazë e projektit vlerësohen në momentin që ato dorëzohen ose prezantohen.
- Vlerësimi i portofolit mund ***të planifikohet si orë e veçantë*** në planifikimin e periudhave ose mund të realizohet përgjatë tri - katër orëve mësimore të periudhës.
- Mësuesi duhet të kujdeset që ***të mos mbingarkojë nxënësin me detyra*** në përfundim të periudhës. Ai, gjithashtu, mund të bashkërendojë punën me mësuesit e lëndëve të tjera për të shmangur ngarkesën e nxënësve.
- Vlerësimi i portofolit ***jodomosdoshmërisht*** bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e gjykon vetë kohën se kur do të zhvillojë vlerësimin e portofolit.
- Në momentin që mësuesi ka përfunduar me ***vlerësimin e detyrave të portofolit dhe të projektit ose të një faze të tij,*** notat e portofolit i vendos në regjistër.



- Mësuesi duhet t'i udhëzojë nxënësit që t'i ruajnë detyrat e portofolit deri në përfundim të vitit shkollor ose t'i mbajë vetë këto detyra.

Detyrat e portofolit vlerësohen në përgjithësi kur ato dorëzohen dhe nuk lihen për në fund kur vlerësohet i gjithë portofoli.

*Mësuesi duhet të kujdeset që të mos mbingarkojë nxënësin me detyra në përfundim të periudhës. Ai, gjithashtu, mund të rakordojë punën me mësuesit e lëndëve të tjera për të menaxhuar ngarkesën e nxënësve, si p.sh të gjithë mësuesit mund ti realizojnë projektet kurrikulare sipas fushave.*

**Për vlerësimin e punimeve të portofolit duhen përcaktuar kritere, të cilat duhet të njihen nga të gjithë nxënësit. Ata vlerësohen:**

- *Për cilësinë e materialeve dhe të punimeve;*
- *Për seriozitetin e përgatitjes së portofolit;*
- *Për aftësinë për të rishikuar, shkruar dhe eksperimentuar në mënyra të ndryshme;*
- *Për aftësinë për të shfrytëzuar burime të ndryshme informacioni;*
- *Për aftësinë për të mbrojtur punën e bërë;*
- *Për aftësinë për të mësuar gjëra të reja;*
- *Për aftësinë për të bërë vetëvlerësim, vlerësimin e punës së shokëve etj.*

**Planifikimi I portofolit: Gjinnazi Besnik Sykja, Mësues: Armand HARKA**

**PERIUDHA III: (prill-qershor)**

<i>Nr .</i>	<i>Rubrika/Detyra</i>	<i>Kompetencat kyçe</i>	<i>Kompetencat e fushës</i>	<i>Situata e të nxënët</i>	<i>Rezultatet e të nxënët që synohen të arrihen</i>	<i>Pikët</i>
<b>1</b>	<p><b>Detyra I.</b> Krijo një projekt te ri ne VB. Shto një textbox, një label dhe një buton në forme.</p> <p>Shkruaj një program që i kërkon përdoruesit të shtypin një numër ndërmjet 17 dhe 31.</p> <p>Kur klikohet butoni, kodi kontrollon numrin e shkruar në textbox. Nëse është ndërmjet 17 dhe 31, atëherë të shfaqë një mesazh bashkë me numrin. Nëse nuk është midis 17 dhe 31, atëherë të afishohet një mesazh tjetër dhe të fshihet përmbajtja e textbox</p>	<p><b>1.Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit</b></p> <p><b>2.Kompetenca e të menduarit</b></p> <p><b>3.Kompetenca e të nxënët</b></p> <p><b>4.Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b></p> <p><b>5.Kompetenca</b></p>	<p><b>1.Hetimi në TIK</b> <b>Nxënësi:</b> -planifikon dhe paraqet kërkime -analizon burime informacioni elektronike</p> <p><b>2. Krijimi në TIK</b> <b>Nxënësi:</b> -krijon, promovon dhe paraqet një transmetim për një audience të gjerë. -bashkëpunon për të planifikuar dhe prezantuar një produkt digjital</p> <p><b>3. Komunikimi në TIK</b> <b>Nxënësi:</b> -zgjedh software të përshtatshëm për qëllime të veçanta. -bën rekomandime për</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>-Hap Visual studio dhe krijo një projekt të ri për të zgjidhur detyrën</p>	<p>Nxënësi/ja:</p> <p>1. Koncepton funksionet dhe procedurat ne VB 2.Thellon njohuritë mbi përdorimet e formave , kontrolleve dhe kodeve ne VB. 3. Përdor strukturat e kontrollit ne VB. 4. Përdor programin kompjuterik Microsoft Word për përpunimin e të dhënave.</p>	15

2	<p><b>Detyra II.</b></p> <p>Ndërto një program ne JAVA që merr një numër të plotë nga përdoruesi dhe llogarit katrorin e tij</p>	<p><b>personale</b></p> <p><b>6.Kompetenca qytetare</b></p> <p><b>7.Kompetenca digjitale</b></p>	<p>përdorimin etik të pajisjeve të reja.</p> <p><b>4. Menaxhimi dhe Operimi në TIK</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <p>-analizon dhe krahason përgjegjësitë e TIK</p> <p>-bën dallimin ndërmjet funksioneve të sistemeve operative software dhe aplikacioneve software.</p>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <p>Zbaton rregullat për një shkrim të saktë të një programi në gjuhën Java.</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>1.Koncepton sintaksën e saktë për shkrimin e një programi në gjuhën Java</p> <p>2. Shkruan programin.</p> <p>3.E ekzekuton programin duke marrë rezultatin e duhur.</p> <p>4.I ruan në programin Word dhe i printon</p>	15
3	<p><b>Detyra III.</b></p> <p><b>Projekti “Aspekte nga rrjetet, Ms.access, JS dhe VB”</b></p> <p>(Faza III)</p>		<p><b>5. Zbatimi i protokolleve dhe praktikave sociale dhe etike kur përdorin TIK-un.</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <p>-përdor një sërë strategjish për sigurimin dhe mbrojtjen e informacionit.</p> <p>- vlerëson ndikimin e TIK-ut në vendin e punës dhe në shoqëri.</p>	<p>Prezantim dhe diskutim në klasë.</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>1. Prezanton përmbledhjen e punëve të grupeve në CD.</p> <p>2.Dorëzon punimin e grupit</p> <p>3. Çdo nxënës dorëzon në CD e grupit dhe informacionin e tij te grumbulluar për projektin</p>	20

*Afati i dorëzimit të detyrave është një javë pas dhënies së tyre.*

*Vlerësimi i portofolit:*

**Detyra 1.**

Kriteret Pikët	1.Eстетika e prezantimit dhe e punimit.	2. Origjinaliteti	3.Argumentimi dhe përpunimi i informacionit	4.Respektimi i afatit kohor
15	2	2	9	2

**Detyra 2.**

Kriteret Pikët	1.Eстетika e prezantimit dhe e punimit.	2. Saktësia shkencore dhe gjuhësore	3. Përdorimi i sakte i elementëve të gjuhës Java	4.Respektimi i afatit kohor
15	2	2	9	2

**Detyra 3.**

Kriteret Pikët	1. Saktësia shkencore dhe gjuhësore	2 Estetika e prezantimit dhe e punimit	3. Menaxhimi dhe përpunimi i informacionit	4.Eseja, përmbledhja (origjinaliteti dhe plotësia)	5. Etika e punës në grup	6.Respektimi i afatit kohor
20	4	3	4	5	2	2

	<b>Niveli I</b>	<b>Niveli II</b>		<b>Niveli III</b>		<b>Niveli IV</b>	
<b>Pikë</b>	0 – 12	13 - 19	20- 26	27- 32	33- 38	39 - 44	45 - 50
<b>Nota</b>	4	5	6	7	8	9	10

## Vlerësim individual për portofolin

**Emri i nxënësit :** \_\_\_\_\_

**Klasa XI -**

**Lënda: TIK**

**Fusha: TEKNOLOGJIA DHE TIK**

**Shkolla: "Besnik Sykja"**

**Periudha III(prill-qershor)**

**Detyra I.** Krijoni një projekt të ri në VB. Shtoni një textbox, një label dhe një buton në formë. Shkruani një program që i kërkon përdoruesit të shtypin një numër ndërmjet 17 dhe 31. Kur klikohet butoni, kodi kontrollon numrin e shkruar në textbox. Nëse është ndërmjet 17 dhe 31, atëherë të shfaqë një mesazh bashkë me numrin. Nëse nuk është midis 17 dhe 31, atëherë të afishohet një mesazh tjetër dhe të fshihet përmbajtja e textbox.

Kriteret Pikët	1.Eстетika e prezantimit dhe e punimit.	2.Originaliteti	3.Argumentimi dhe përpunimi i informacionit	4.Respektimi i afatit kohor	Pikët e marra
15	2	2	9	2	

### **Detyra II.**

Ndërtoni një program në JAVA që merr një numër të plotë nga përdoruesi dhe llogarit katrorin e tij.

Kriteret Pikët	1.Eстетika e prezantimit dhe e punimit.	2. Saktësia shkencore dhe gjuhësore	3. Përdorimi i sakte i elementëve të gjuhës Java	4.Respektimi i afatit kohor	Pikët e marra
15	2	2	9	2	

### **Detyra III.**

**Projekti: "Aspekte nga rrjetet, Ms.access, JS, VB" (Faza III)**

Kriteret Pikët	1. Saktësia shkencore dhe gjuhësore	2 Estetika e prezantimit dhe e punimit	3. Menaxhimi dhe përpunimi i informacionit	4.Eseja ose përmbledhja (origjinaliteti dhe plotësia)	5. Etika e punës në grup	6.Respektimi i afatit kohor	Pikët e marra
20	4	3	4	5	2	2	

PIKËT E GRUMBULLUARA \_\_\_\_\_

VLERËSIMI ME NOTË \_\_\_\_\_

	Niveli I	Niveli II		Niveli III		Niveli IV	
<b>Pikë</b>	0 – 12	13 - 19	20- 26	27- 32	33- 38	39 - 44	45 - 50
<b>Nota</b>	4	5	6	7	8	9	10

MËSUESI I LËNDËS  
Armand HARKA

## XI. Bibliografia:

- Armstrong, Thomas. 7 Kinds of Smart: Identifying and Developing Your Multiple Intelligences. Neë York: Plume, 1999.
- Armstrong, Thomas. In Their Oën Ęay: Discovering and Encouraging Your Child's Multiple Intelligences, Neë York: Tarcher/Putnam, 2000.
- Armstrong, Thomas. Multiple Intelligences in the Classroom 4th ed. Alexandria, VA: Association for Supervision and Curriculum Development, 2018.
- Armstrong, Thomas. You're Smarter Than You Think: A Kid's Guide to Multiple Intelligences. Minneapolis, MN: Free Spirit, 2014.
- Checkley, K. (1997). The first seven...and the eighth: A conversation Ęith Hoëard Gardner. *Educational Leadership*, 55 (1). [Online]. Available: [www.ascd.org/pubs/el/sept97/gardnerc.html](http://www.ascd.org/pubs/el/sept97/gardnerc.html)
- Christison, M. (1998). An introduction to multiple intelligence theory and second language learning. In J. Reid (Ed.), *Understanding learning styles in the second language classroom*. (pp. 1-14). Neë Jersey: Prentice Hall.
- Gardner, H. (1983). *Frames of mind: The theory of multiple intelligences*. Neë York: Basic Books.
- Gardner, H. (1993). *Multiple intelligences: The theory in practice*. Neë York: Basic Books.
- Gardner, H. (1999). *Intelligence reframed: Multiple intelligences for the 21st century*. Neë York: Basic Books.
- IZHA, 2014, Korniza kurrikulare.
- IZHA, 2014, Kurrikula bërthamë AMU, klasat 10-12.
- IZHA, 2014-2018, Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat 10-11-12.
- IZHA, 2015, Korniza e vlerësimit të nxënësit.
- IZHA, 2016, Nivelet e arritjes (arsimi bazë).
- IZHA, 2017, Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të lartë..